

## Sistemet

### Pyetja 1

Shpërhapja e thjeshtë (difuzioni) është mënyra pasive e përshkueshmërisë së membranës plazmatike. Ajo është lëvizje e molekulave nga:

- A) mjedisi me përqendrim më të ulët tek mjedisi me përqendrim më të lartë
- B) mjedisi me përqendrim më të lartë tek mjedisi me përqendrim më të ulët
- C) njëri mjedis në tjetrin kur përqendrimi nuk ndryshon
- D) njëri mjedis në tjetrin duke kërkuar energji

### Pyetja 2

Gradienti i përqendrimit shpreh:

- A) diferencën e përqendrimit të një lënde ndërmjet mjedisit të jashtëm e atij të brendshëm
- B) ekuilibrin statik mes dy anëve të membranës plazmatike
- C) lëvizjen e sheqerit në brendësi të qelizës
- D) spostimin e lëndëve brenda qelizës

### Pyetja 3

Shpërhapja e ujit përmes membranës gjysmë të përshkueshme quhet ndryshe:

- A) difuzion
- B) osmozë
- C) transport aktiv
- D) difuzion i lehtësuar

### Pyetja 4

Plazmoliza është procesi i kalimit të ujit nga:

- A) brenda qelizës në vakuolë
- B) brenda qelizës – jashtë saj
- C) jashtë qelizës – brenda saj
- D) potenciali më i lartë drejt atij më të ulët

### Pyetja 5

Shpërhapja e lehtësuar ndihmon kalimin e molekulave të mëdha(p.sh. sheqernat) nëpërmjet:

- A) poreve membranore
- B) organeleve qelizore
- C) proteinave qelizore
- D) proteinave transportuese

### Pyetja 6

Transporti aktiv kryhet:

- A) në drejtim të gradientit të përqendrimit
- B) në të njëjtin drejtim me shpërhapjen e lehtësuar
- C) në drejtim të kundërt me gradientin e përqendrimit
- D) në të njëjtin drejtim me shpërhapjen, pa shpenzim energjie

Pyetja 7

Transporti aktiv kryhet me ndihmën e:

- A) kolesterolit
- B) fosfolipideve
- C) glukoproteinave
- D) pompave membranore

Pyetja 8

Pompa natrium – kalium:

- A) quhet ndryshe ATP-azë
- B) nuk është proteinë integrale membranore
- C) transporton jonet kalium nga brenda jashtë qelizës
- D) transporton jonet natrium nga jashtë brenda qelizës

Pyetja 9

Transporti i lëndëve me përmasa shumë të mëdha nëpërmjet membranës plazmatike realizohet nëpërmjet:

- A) endocitozës dhe ekzocitozës
- B) shpërhapjes së lehtësuar
- C) shpërhapjes së thjeshtë
- D) transportit aktiv

Pyetja 10

Pinocitoza është procesi nëpërmjet të cilit qeliza merr nga mjedisi:

- A) lëngje
- B) sheqer
- C) amidon
- D) aminoacide

Pyetja 11

Endocitoza është procesi i cili njihet ndryshe si transport:

- A) me fshikëza
- B) me kanale
- C) i thjeshtë
- D) pasiv

Pyetja 12

Pinocitoza është procesi nëpërmjet të cilit qeliza merr nga mjedisi:

- A) yndyrna të pa tretshme
- B) glicerinë
- C) lëngje
- D) vajra

Pyetja 13

Endocitoza me ndërmjetësinë e receptorëve mundëson transportin në qelizë të:

- A) baktereve
- B) kolesterolit
- C) aminoacideve
- D) joneve  $\text{Na}^+ - \text{K}^+$

Pyetja 14

Ekzocitoza është proces që mundëson transportin jashtë qelizës të:

- A) neuroneve
- B) receptorëve
- C) hormoneve
- D) joneve  $\text{Na}^+$ - $\text{K}^+$

Pyetja 15

Shpërhapja(difuzioni) është procesi i lëvizjes rastësore të molekulave, nën veprimin e energjisë:

- A) kimike
- B) elektrike
- C) kinetike
- D) termike

Pyetja 16

Shpejtësia me të cilën lëndët shpërhapen përmes membranës plazmatike varen nga një sërë faktorësh. Njeri prej tyre është:

- A) trysnia
- B) katalizatori
- C) drita e diellit
- D) diferenca e përqendrimeve

Pyetja 17

Cila nga këto lëndë transportohen me anë të ksilemës:

- A) uji
- B) sheqernat
- C) oksigjeni
- D) hormonet

Pyetja 18

Transporti i lëndëve organike te bimët quhet:

- A) translokim
- B) translatim
- C) transpirim
- D) transferim

Pyetja 19

Thithja e uji nga toka, përmes qimeve thithëse realizohet me:

- A) shpërhapje të lehtësuar
- B) transport aktiv
- C) pinocitozë
- D) osmozë

Pyetja 20

Uji lëviz nga rrënjët për në pjesët e tjera të bimës me anë të:

- A) gypave të ksilemës
- B) gypave të floemës
- C) rrugës apoplaste
- D) rrugës simplaste

Pyetja 21

Cili nga organet e mëposhtme shërben si organ burim?

- A) Vezorja
- B) Thekët
- C) Gjethja
- D) Dega

Pyetja 22

Traket dhe Trakeidet janë përbërës të:

- A) sklerenkimës
- B) kolenkimës
- C) ksilemës
- D) floemës

Pyetja 23

Kohezioni është dukuria ku molekulat e ujit:

- A) arrijnë të ndahen nga njëra tjetra
- B) krijojnë lidhje hidrogjenore
- C) lidhen me molekula të tjera
- D) krijojnë lidhje kovalente

Pyetja 24

Floema është e ndërtuar nga:

- A) trake dhe trakeide
- B) parenkimatike dhe sklerenkimatike
- C) gypat me shoshë dhe qelizat shoqëruese
- D) kambiumit të Tapes dhe kambiumit Enëzor

Pyetja 25

Kur një bimë futet në një qese plastike, humbja e ujit është:

- A) më e madhe sepse rritet lagështia
- B) më e madhe sepse ulet lagështia
- C) më e vogël sepse rritet lagështia
- D) më e vogël sepse ulet lagështia

Pyetja 26

Kur gypat me shoshë priten, rrjedha lëviz:

- A) në të njëjtin drejtim
- B) në drejtim të kundërt
- C) në qelizat e ksilemës
- D) në qelizat e mezofilit

Pyetja 27

Shumica e produkteve që prodhohen me anë të fotosintezës në gjethe, transportohen në formën e:

- A) aminoacideve
- B) proteinave
- C) sakarozës
- D) lipideve

Pyetja 28

Në cilat nga kushtet e mëposhtme të motit transpirimi do të jetë më i shpejtë:

- A) nxehtësi, thatësi dhe erë
- B) nxehtësi, thatësi dhe mot pa erë
- C) freski, thatësi dhe erë
- D) freski, lagështi dhe mot pa erë

Pyetja 29

Tek bima, hormonet bimorë rregullojnë shumë procese fiziologjike. Njëri nga emrat më poshtë përfaqëson një hormon bimor:

- A) giberelinë
- B) glicinë
- C) glikogjen
- D) globinë

Pyetja 30

Njëri nga emrat më poshtë NUK i përket një hormoni bimor:

- A) ABA – acidi abshisik
- B) giberelinë
- C) globinë
- D) auksinë

Pyetja 31

Hormonet bimorë prodhohen:

- A) në inde bimorë
- B) në organe bimorë
- C) në gjëndra të specializuara
- D) në qeliza të specializuara si tek kafshët

Pyetja 32

Hormonet bimorë transportohen në bimë nëpërmjet:

- A) transportit aktiv dhe shpërhapjes
- B) vetëm përmes transportit aktiv
- C) murit prej celuloze
- D) indit mbulues

Pyetja 33

Shkëmbimi i gazeve te gjitarët ndodh në:

- A) trake
- B) bronke
- C) alveola
- D) bronkiola

Pyetja 34

Është pjesë vetëm e aparatit të frymëshkëmbimit:

- A) goja
- B) trakea
- C) faringu
- D) ezofagu

Pyetja 35

Cili prej termave përdoret për të përshkruar lëvizjen e gazeve nga një mjedis me përqendrim më të lartë drejt një mjedisi me përqendrim më të ulët?

- A) Tcurrje
- B) Avullim
- C) Difuzion
- D) Transport aktiv

Pyetja 36

Cila nga strukturat e mëposhtme ndahet në dy bronke?

- A) Trakea
- B) Faringu
- C) Laringu
- D) Ezofagu

Pyetja 37

Pjesa e përbashkët që i përket edhe aparatit tretës edhe aparatit të frymëkëmbimit është:

- A) trakea
- B) faringu
- C) laringu
- D) ezofagu

Pyetja 38

Gjatë frymëhithjes (inspirimit) vëllimi i mushkërive:

- A) zvogëlohet dhe dioksidi i karbonit del jashtë
- B) zmadhohet dhe diafragma ulet poshtë
- C) zvogëlohet dhe oksigjeni hyn brenda
- D) zmadhohet dhe diafragma ngrihet

Pyetja 39

Gjatë frymënxjerrjes (ekspirimit) vëllimi i mushkërive:

- A) zvogëlohet dhe diafragma ngrihet
- B) zmadhohet dhe diafragma ngrihet
- C) zmadhohet dhe oksigjeni hyn brenda
- D) zvogëlohet dhe diafragma ulet poshtë

Pyetja 40


Trakea, gypi i kalimit të ajrit është i pajisur me qeliza që prodhojnë:

- A) mukus
- B) amilazë
- C) acid karbonik
- D) acid klorhidrik

Pyetja 41

Shigjeta me numrin 2 në figurën e mëposhtme tregon:

- A) Bronket
- B) Trakenë
- C) Hojëzat
- D) Pleurën



Pyetja 42

Membrana e dyfishtë që vesh mushkëritë quhet?

- A) Septum
- B) Diafragma
- C) Pleura
- D) Peritoneum

Pyetja 43

Pjesa kërcore që mbyll trakenë dhe pengon ushqimin të kalojë në të gjatë gëlltitjes quhet?

- A) Epiglotë
- B) Kutia e zërit
- C) Kordat e zërit
- D) Qelizat kupë

Pyetja 44

Degëzime e holla që përfundojnë në hojëza(alveola) quhen?

- A) Bronkiola
- B) Bronke
- C) Trake
- D) Cilie

Pyetja 45

Mukusi prodhohet nga qelizat:

- A) kupë
- B) ciliare
- C) qerpikore
- D) epiteliale

Pyetja 46

Në cilën pjesë të gypit tretës sekretohet lëngu pankreatik?

- A) Ezofagu
- B) Stomaku
- C) Ileumi
- D) Duodeni

Pyetja 47

Sasia e lartë e yndyrnave të ngopura në dietën ushqimore rrit përqendrimin e:

- A) kolesterolit në gjak
- B) fosfolipideve në gjak
- C) aminoacideve në gjak
- D) karbohidrateve në gjak

Pyetja 48

Zbërthimi i molekulave ushqimore të mëdha të patretshme në molekula të vogla të tretshme quhet?

- A) Përthithje
- B) Tretje
- C) Ekskretim
- D) Gëlltitje

Pyetja 49

Cili është përshkrimi i saktë i veprimit të një proteaze. Ajo shpërbën:

- A) glikogjenin në glukozë
- B) yndyrnat në acide yndyrore
- C) proteinat në aminoacide
- D) aminoacidet në proteina

Pyetja 50

Sasia më e madhe e energjisë ushqimore ndodhet tek:

- A) sheqernat
- B) proteinat
- C) vitaminat
- D) yndyrnat

Pyetja 51

Procesi i shndërrimit të glukozës në glikogjen ndodh në:

- A) pankreas
- B) zorrë
- C) stomak
- D) mëlçi

Pyetja 52

Organi ku realizohet tretja e plotë kimike është:

- A) stomaku
- B) ezofagu
- C) zorra e hollë
- D) zorra e trashë

Pyetja 53

Radha e vendosjes së organeve në aparatit tretës të njeriut është:


- A) goja-ezofagu-stomaku-zorra e trashë-zorra e hollë
- B) goja-stomaku-ezofagu-zorra e trashë-zorra e hollë
- C) goja-stomaku-ezofagu-zorra e hollë-zorra e trashë
- D) goja-ezofagu-stomaku-zorra e hollë-zorra e trashë



Pyetja 54

Në figurën e mëposhtme identifikoj strukturën me numrin 3:

- A) ezofagu
- B) stomaku
- C) mëlçia
- D) pankreasi



Pyetja 55

Cila nga substancat e mëposhtme bën pjesë të kemiotrofët:

- A) aminoacidet
- B) glukozja
- C) sakarozja
- D) hekuri

Pyetja 56


Ezofagu është rruga e kalimit të:

- A) ajrit
- B) gjakut
- C) ushqimit
- D) limfës

Pyetja 57

Në figurën e mëposhtme struktura me numrin 2 tregon:

- A) pankreasi
- B) stomaku
- C) ezofagu
- D) mëlçia



Pyetja 58

Gypi tretës në pjesën e brendshme vishet nga shtresa të indit:

- A) muskolor
- B) epitelial
- C) lidhor
- D) nervor

Pyetja 59

Limfocitet B maturohen në:

- A) timus
- B) bajame
- C) shpretkë
- D) palcën e kuqe kockore

Pyetja 60

Limfocitet T maturohen në:

- A) timus
- B) bajame
- C) shpretkë
- D) palcën e kuqe kockore

Pyetja 61

Lizozima gjendet tek:

- A) lotët
- B) dylli i veshit
- C) lëngu gastrik
- D) lëngu pankreatik

Pyetja 62

Cila nga këto sëmundje është infektive?

- A) Gripi
- B) Talasemia
- C) Hipertensioni
- D) Diabeti melitus

Pyetja 63

Cila nga këto lloje rruazash gjaku ka aftësi të kryejë fagocitozë?

- A) Eritrocite
- B) Limfocitet B
- C) Limfocitet T
- D) Leukocitet

Pyetja 64

Cilën nga këto funksione kryejnë Leukocitet?

- A) Prodhojnë hemoglobinën
- B) Transportojnë oksigjenin
- C) Transportojnë glukozën
- D) Mbrojtjen ndaj infeksioneve

Pyetja 65

Limfocitet ndahen në:

- A) limfocite A dhe B
- B) limfocite A dhe C
- C) limfocite B dhe C
- D) limfocite B dhe T

Pyetja 66

Antitruapat pasi prodhohen:

- A) dalin jashtë me djersën
- B) dalin jashtë me feçet
- C) qarkullojnë në gjak
- D) ruhen në palcën e kockave

Pyetja 67

Antitruapat janë proteina të përbëra nga:

- A) një zinxhir i rëndë dhe dy zinxhirë të lehtë
- B) dy zinxhirë të rënda dhe dy zinxhirë të lehtë
- C) dy zinxhirë të rëndë dhe një zinxhir i lehtë
- D) tre zinxhirë të rëndë dhe një zinxhir i lehtë

Pyetja 68

Vaksinimi shkakton:

- A) imunitet aktiv artificial
- B) imunitet pasiv artificial
- C) imunitet aktiv natyral
- D) imunitet pasiv natyral

Pyetja 69

Procesi me anë të cilit rruazat e bardha të gjakut gëlltisnin bakteret quhet?

- A) Ekzocitozë
- B) Fagocitozë
- C) Leukocitozë
- D) Pinocitozë

Pyetja 70

Fibrinogjeni kthehet në fibrinë dhe realizon koagulimin e gjakut. Fibrinogjeni është:

- A) lëndë hormonale
- B) lëndë sheqerore
- C) lëndë proteinike
- D) lëndë yndyrore

Pyetja 71

Cili prej hormoneve do të sekretohet kur rritet sasia e sheqerit në gjak?

- A) Insulina
- B) Glukagoni
- C) Kortizoli
- D) Tiroksina

Pyetja 72

Cila nga strukturat përgjigjet për sekretimin e hormonit kundër urinimit?

- A) Adenohipofiza
- B) Gjendra mbiveshkore
- C) Neurohipofiza
- D) Tërmishëza

Pyetja 73

Hipotalamusi NUK kontrollon sekretimin e hormoneve:

- A) FSH dhe LH
- B) të pankreasit
- C) të rritjes(GH)
- D) ACTH

Pyetja 74

Cili nga parametrat e mëposhtëm NUK është parametër homeostatik?

- A) Peshë trupore
- B) pH i gjakut
- C) Sasia e ujit
- D) Përqendrimi i  $Ca^{2+}$

Pyetja 75

Rregullimi i temperaturës së trupit kontrollohet nga:

- A) hipotalamusi
- B) truri i madh
- C) truri i vogël
- D) hipofiza

Pyetja 76

Ndjesia e etjes kontrollohet nga:

- A) hipotalamusi
- B) truri i madh
- C) truri i vogël
- D) hipofiza

Pyetja 77

Hormoni folikulo – stimulues(FSH) dhe hormoni luteinizues (LH) që rregullojnë prodhimin e hormoneve seksuale mashkullore dhe femërore prodhohen nga:

- A) pankreasi
- B) hipotalamusi
- C) neurohipofiza
- D) adenohipofiza

Pyetja 78

Hormoni i cili ndikon në procesin e rritjes dhe në metabolizëm prodhohet nga:

- A) tiroidja
- B) pankreasi
- C) hipotalamusi
- D) adenohipofiza

Pyetja 79

Nëse niveli i sheqerit në gjak është i ulët, qelizat e pankreasit do të:

- A) sekretojnë sasi më të madhe insuline
- B) sekretojnë sasi më të vogël glukagoni
- C) sekretojnë sasi më të madhe glukagoni
- D) ndërpresin sekretimin e hormoneve

Pyetja 80

Ruajtja e qëndrueshmërisë së mjedisit të brendshëm të organizmit quhet?

- A) Homeoplazi
- B) Homeostazë
- C) Homeopati
- D) Homozigotë

Pyetja 81

Homeostaza është tërësia e mekanizmave që rikthejnë parametrat e ndryshuar të lëngut indor në:

- A) vlerën maksimale
- B) vlerën minimale
- C) vlerën optimale
- D) vlerën mesatare

Pyetja 82

Nëse pH dhe temperatura nuk kthehen në vlerën optimale, do të dëmtohej struktura e:

- A) acideve nukleike
- B) enzimave
- C) glukozës
- D) lipideve

Pyetja 83

Funksioni i enzimave është:

- A) të ulin energjinë e aktivizimit
- B) të rritin energjinë e aktivizimit
- C) të zvogëlojnë shpejtësinë e reaksionit
- D) të realizojnë edhe reaksionet e pamundura

Pyetja 84

Rregullimi i temperaturës së trupit realizohet përmes:

- A) feedback-ut negativ
- B) feedback-ut pozitiv
- C) të dy llojeve të feedback-ëve
- D) përmes një mekanizmi hormonal

Pyetja 85

Sistemi nervor qendror përbëhet nga:

- A) fjetet nervore dhe ganglionet
- B) truri dhe palca kurrizore
- C) truri i madh dhe i vogël
- D) ura dhe palca e zgjatur

Pyetja 86

Funksioni i një neuroni është:

- A) ushqyes
- B) termorregullues
- C) mbrojtës dhe lëvizor
- D) të kapë dhe tejçojë ngacmimet

Pyetja 87

Mielina prodhohet nga:

- A) qelizat gliale
- B) qelizat nervore
- C) qelizat e Ranvie
- D) qelizat e Shvanit

Pyetja 88

Një sinaps kimik është:

- A) lidhja midis qelizave të një indit
- B) zona ku kalojnë neurotransmetuesit
- C) një vazhdimësi anatomike e dy neuroneve
- D) pika e takimit të enëve të gjakut me qelizat

Pyetja 89

Bërthama dhe organelat qelizore të një neuroni ndodhen në:

- A) akson
- B) sinaps
- C) dentrite
- D) trup (soma)

Pyetja 90

Mbështjellja që prodhohet nga qelizat e Shvanit dhe që shërben për të izoluar aksonet quhet?

- A) Aktinë
  - B) Mielinë
  - C) Miozinë
  - D) Tripsinë
- PS) B

Pyetja 91

Lënda kimike që ndërmjetëson kalimin e nxitjes nervore nga neuroni parasinaptik në atë passinaptik quhet?

- A) Interferon
- B) Hormon
- C) Neurohormon
- D) Neurotransmetues

Pyetja 92

Neurotransmetuesit çlirohen nga:

- A) aksoni i neuronit passinaptik
- B) butoni i neuronit parasinaptik
- C) dentritet e neuronit passinaptik
- D) trupi i neuronit passinaptik

Pyetja 93

Neuroni është:

- A) qelizë pa bërthamë
- B) qelizë që nuk riprodhohet
- C) qelizë që riprodhohet
- D) qelizë shumëbërthamore

Pyetja 94

Aksoni është pjesë e:

- A) nefronit
- B) neuronit
- C) embrionit
- D) kromozomit

Pyetja 95

Drejtimi i përhapjes së nxitjes nervore është:

- A) nga trupi (soma), përmes aksonit, tek butoni
- B) nga aksoni, tek trupi, tek dentritet e një neuroni
- C) nga dentritet, tek aksoni, tek trupi i një neuroni
- D) nga trupi, tek dentritet, tek aksoni i një neuroni

Pyetja 96

Dentritet e një neuroni dallohen nga aksoni sepse:

- A) dalin nga aksonet
- B) dërgojnë nxitjen në akson
- C) janë më të gjata se aksoni
- D) janë më të shkurtra se aksoni

Pyetja 97

Nervi është një tufë:

- A) aksonesh të neuroneve
- B) dentritesh të neuroneve
- C) fijesh muskulore
- D) fijesh proteinike

Pyetja 98

Njësia ndërtimore dhe funksionale e sistemit nervor është?

- A) Nefroni
- B) Neuroni
- C) Palca kurrizore
- D) Truri

Pyetja 99

Procesi i largimit të produkteve të metabolizmit qelizor nga trupi ynë njihet si:

- A) ekskretim
- B) riprodhim
- C) lëvizje
- D) tretje

Pyetja 100

Funksioni i veshkave monitorohet dhe rregullohet nga:

- A) mekanizmat i feedback-ut
- B) mekanizmat e kontraktimeve
- C) veprimet reflektore
- D) asnjë nga këto

Pyetja 101

Funksioni i tubulës së nefronit është të:

- A) realizojë reabsorbimin e lëndëve të ndryshme
- B) lidh veshkën me fshikëzën e urinës
- C) shërbejnë si depozitë për urinën
- D) eliminojnë urinën

Pyetja 102

Shumica e substancave të panevojshme, të pranishme në urinë rrjedhin nga metabolizmi i:

- A) lipideve
- B) proteinave
- C) sheqernave
- D) kripërave minerale

Pyetja 103

Në rast dehidratimi ndodh:

- A) rritja e vëllimit të gjakut
- B) prodhimi i urinës shumë të holluar
- C) ulja e përqendrimit të lëndës së tretur
- D) prodhimi i urinës shumë të koncentruar

Pyetja 104

Tek njerëzit, ultrafiltrati i marrë në kapsulën e Bauman-it, në kushte normale është i përbërë nga:

- A) ujë, ure, urinë
- B) acidi urik dhe ujë
- C) ujë, glukozë, ure dhe kripëra
- D) proteina, qelizat e kuqe të gjakut, ujë

Pyetja 105

Në veshka, riabsorbimi selektiv i glukozës ndodh në nivelin e:

- A) gypave të përdredhur proksimal
- B) kapsulës Bauman
- C) lakut Henle
- D) glomerulës

Pyetja 106

Në rastin kur sasia e marrjes së lëngjeve është e ulët:

- A) rritet prodhimi i urinës
- B) veshka kthen më pak ujë në gjak
- C) urina është më pak e përqendruar
- D) hipotalamusi prodhon më shumë ADH

Pyetja 107

Cila nga substancat NUK mund të kalojë përmes endotelit të kapilarëve të glomerulës?

- A) Globina
- B) Glukozë
- C) Qelizat e gjakut
- D) Qelizat gjakut dhe proteinat

Pyetja 108

Arsyeja pse veshka e djathtë është pak më e ulët se e majta ka të bëjë me:

- A) veshka e majtë është më e madhe se e djathta
- B) hapësirën e konsiderueshme të zënë nga zemra
- C) veshka e djathtë është më e madhe se e majta
- D) hapësirën e konsiderueshme të zënë nga mëlçia, në anën e djathtë

Pyetja 109

Veshkat në trupin e njeriut shtrihen në nivelin e:

- A) vertebrës së 5-të, të kraharorit, deri tek vertebra e 3-të, e mesit
- B) vertebrës së 8-të, të kraharorit, deri tek vertebra e 12-të, e mesit
- C) vertebrës së 10-të, të kraharorit, deri tek vertebra e 5-të, e mesit
- D) vertebrës së 12-të, të kraharorit, deri tek vertebra e 3-të, e mesit



Pyetja 110

Rritja e përshkueshmërisë së qelizave të Lakut të Henlit, ndaj ujit është për shkak të:

- A) uljes së prodhimit të ADH-së
- B) rritjes së prodhimit të ADH-së
- C) rritjes së prodhimit të aldosteronit
- D) uljes së përqendrimit të plazmës së gjakut

Pyetja 111

Te kafshët e shkretëtirës dominojnë nefronet që kanë Lakun e Henlit:

- A) me gjatësi të njëjtë si te njeriu
- B) më të shkurtër se te njeriu
- C) më të gjatë se te njeriu
- D) në mungesë

Pyetja 112

Hormoni kundër-urinimit(ADH) prodhohet nga:

- A) folikulat
- B) hipotalamusi
- C) trupi i verdhë
- D) neurohipofiza

Pyetja 113

ADH-ja përfaqëson hormonin që:

- A) ul reabsorbimin fosfatit.
- B) rrit riabsorbimin e H<sub>2</sub>O-së.
- C) ul riabsorbimin e natriumit.
- D) rrit riabsorbimin e natriumit.

Pyetja 114

Ka përqëndrim të ulët të uresë:

- A) arteriola aferente
- B) kapsula Baumanit
- C) fshikëza e urinës
- D) arteriola eferente

Pyetja 115

Cila nga llojet e mbetjeve të azotuarra NUK ekskretohet nga organizmat e gjallë?

- A) Ure
- B) Amoniaku
- C) Acidi urik
- D) Acidi nitrik

Pyetja 116

Cili nga proceset e mëposhtme nuk ndodh gjatë formimit të urinës?

- A) Filtrimi glomerular
- B) Riabsorbimi
- C) Asimilimi
- D) Sekretimi

Pyetja 117

Bimët e reja rriten në sajë të ndarjes së qelizave me:

- A) mitozë
- B) mejozë
- C) sythëzim
- D) shumim vegjetativ

Pyetja 118

Cilat nga strukturat e mëposhtme përfaqësojnë kërcëjtë nëntokësorë të shndërruar te bimët?

- A) Kladodet
- B) Stolonet
- C) Tuberet
- D) Sythat

Pyetja 119

Cila nga strukturat e mëposhtme përfaqëson një kërcell të shkurtër nëntokësor që rrethohet nga shtresa gjethesh, të pasura me lëndë rezervë?

- A) Bulbi
- B) Tuberet
- C) Rizoma
- D) Kladodet

Pyetja 120

Bimët e patates riprodhohen me lule dhe me tubere. Cila nga këto dy mënyra siguron më pak larmi gjenetike te pasardhësit?

- A) Kryqëzimi i bimëve të varieteteve të ndryshme.
- B) Kryqëzimi i bimëve të të njëjtit varietet.
- C) Prodhimi i tubereve
- D) Vetëpjalnimi.

Pyetja 121

Pllenimi i vezës ndodh në:

- A) tubat e Fallopit
- B) gypin deferent
- C) uterus(mitër)
- D) uretër

Pyetja 122

Disa orë para ovulimit, përqendrimi i:

- A) FSH dhe LH ulet shumë
- B) FSH dhe LH rritet shumë
- C) progesteronit rritet shumë
- D) FSH dhe LH nuk ndryshon

Pyetja 123

Procesi i formimit të plotë të gametëve mashkullorë ndodh në:

- A) gypëzat seminiferë
- B) kanali ejakulator
- C) kanali deferent
- D) epididimë

Pyetja 124

Roli i qelizave intersticiale është të prodhojë:

- A) gonadotropinat hipofizare
- B) hormonin progesteron
- C) hormonin testosteron
- D) hormonin estrogen

Pyetja 125

Pjesa e mesme, “trupi” i spermatozoidit siguron:

- A) gjene
- B) energji
- C) ushqim
- D) kromozome

Pyetja 126

Hormoni FSH stimulon zhvillimin e folikulës tek njeriu. Ndërsa folikula zhvillohet, qelizat folikulare sekretojnë estrogen. Një nivel i lartë i estrogenit, ul sekretimin e FSH. Ky mekanizëm është shembull i:

- A) diferencimit qelizor
- B) feedback-ut negativ
- C) feedback-ut pozitiv
- D) tropizmit pozitiv

Pyetja 127

Estrogjeni ka një efekt të drejtpërdrejtë në:

- A) formimin e një zigote
- B) ndryshimet brenda uterusit(mitrës)
- C) lëvizjen e vezës drejt spermatozoidit
- D) zhvillimin e placentës brenda vezores

Pyetja 128

Lëngu amniotik ka disa funksione, PËRVEÇ:

- A) lejimit të lëvizjes së kufizuar të fetusit
- B) mbrojtjes së embrionit nga goditjet mekanike
- C) mbajtjes së një presion të barabartë rreth embrionit
- D) nxjerrjes jashtë të mbetjeve të azotuara dhe CO<sub>2</sub>

Pyetja 129

Cila nga gjëndrat nuk prodhon hormone?

- A) Pankreasi
- B) Hipofiza
- C) Vezorja
- D) Të pështymës

Pyetja 130

Hormonet që përfshihen në grupin e derivateve të aminoacideve janë:

- A) insulina
- B) hormonet seksuale
- C) hormonet e tiroides
- D) hormonet e hipofizës

Pyetja 131

Ndikojnë në zhvillimin fizik dhe seksual të organizmit, hormonet:

- A) e hipofizës
- B) e pankreasit
- C) e gjëndrës mbiveshkore
- D) e gjëndrave seksuale(gonadeve)

Pyetja 132

Hormone me veti homeostatike janë ato të gjëndrave:

- A) tiroide
- B) seksuale
- C) para tiroide
- D) mbi veshkore

Pyetja 133

Hipofiza është quajtur gjëndër drejtuese sepse:

- A) është pjesë e SNQ
- B) është gjëndër egzokrine
- C) prodhon hormone nxitëse dhe frenuese
- D) hormonet e prodhuara prej saj nxisin gjëndra të tjera endokrine

Pyetja 134

Qeliza shenjë dhe hormoni e njohin njëri tjetrin nga:

- A) përbërja strukturore
- B) poret e qelizës shenjë
- C) aftësia e qelizës shenjë
- D) receptorët e qelizës shenjë

Pyetja 135

Hipotalamusi prodhon:

- A) prolaktinë
- B) oksitocinë
- C) FSH
- D) TSH

Pyetja 136

Cili nga hormonet ka përbërje proteinike?

- A) Insulina
- B) Adrenalina
- C) Hormonet e tiroides
- D) Hormonet seksuale

Pyetja 137

Përfshihet në grupin e hormoneve steroidë:

- A) glukagoni
- B) adrenalina
- C) hormonet seksuale
- D) hormonet e hipofizës

Pyetja 138

Hormonet steroidë veprojnë me:

- A) receptorët brenda qelizorë
- B) receptorët transmembranorë
- C) anën e aktivizimit të AMP-ciklike
- D) anën e ndryshimit të rrjedhës së reaksioneve

Pyetja 139

Për të ndodhur ovulacioni duhet të ndodhë shtimi i:

- A) progesteronit
- B) hormonit LH
- C) testosteronit
- D) estradiolit

Pyetja 140

Cili është hormoni që prodhohet nga vezorja?

- A) Testosteron
- B) Estradiol
- C) ACTH
- D) TSH

Pyetja 141

Cila nga hormonet e prodhuara nga adenohipofiza veprojnë në gonadet seksuale?

- A) FSH dhe LH
- B) TSH dhe GH
- C) ACTH dhe GH
- D) Prolaktinë dhe LH

Pyetja 142

Cili nga hormone frenon prodhimin e FSH dhe LH?

- A) Estradiol
- B) Oksitocinë
- C) Testosteron
- D) Progesteron

Pyetja 143

Hormoni që stimulon prodhimin e spermatozoideve është:

- A) progesteroni
- B) testosteroni
- C) FSH
- D) LH

Pyetja 144

Gjëndrat endokrine:

- A) prodhojnë enzima
- B) janë gjëndra pa kanal
- C) janë gjëndra me kanal
- D) i derdhin produktet jashtë trupit

Pyetja 145

Cila pjesë e zemrës e merr gjakun nga mushkëritë?

- A) Veshorja (atriumi) e majtë
- B) Veshorja (atriumi) e djathtë
- C) Barkushja (ventrikula) e djathtë
- D) Barkushja (ventrikula) e majtë

Pyetja 146

Cila pjesë e zemrës e merr gjakun nga trupi?

- A) Veshorja (atriumi) e majtë
- B) Veshorja (atriumi) e djathtë
- C) Barkushja (ventrikula) e djathtë
- D) Barkushja (ventrikula) e majtë

Pyetja 147

Tregoni cila pjesë e zemrës pompon gjak në arterien mushkërore:

- A) Veshorja (atriumi) e majtë
- B) Veshorja (atriumi) e djathtë
- C) Barkushja (ventrikula) e djathtë
- D) Barkushja (ventrikula) e majtë

Pyetja 148

Tregoni cila pjesë e zemrës pompon gjak në aortë:

- A) Veshorja (atriumi) e majtë
- B) Veshorja (atriumi) e djathtë
- C) Barkushja (ventrikula) e djathtë
- D) Barkushja (ventrikula) e majtë

Pyetja 149

Enët e gjakut, të cilat nxjerrin gjakun nga zemra janë:

- A) venat
- B) arteriet
- C) venulat
- D) kapilarët

Pyetja 150

Enët e gjakut, të cilat sjellin gjakun nga zemra janë:

- A) venat
- B) venulat
- C) kapilarët
- D) arteriolat

Pyetja 151

Skorbuti shkaktohet nga mungesa e:

- A) vitaminës A
- B) vitaminë B
- C) vitaminë C
- D) vitaminë D

Pyetja 152

Cili nga pohimet e mëposhtme është më i plotë lidhur me përbërjen e gjakut?

- A) Përmban vetëm plazmën e gjakut
- B) Përmban plazmën dhe qelizat e bardha
- C) Përmban qelizat e bardha dhe qelizat e kuqe
- D) Përmban plazmën, qelizat e kuqe dhe qelizat e bardha

Pyetja 153

Qarkullimi i vogël i gjakut, te gjitarët, e merr fillimin nga:

- A) Veshorja (atriumi) e majtë
- B) Veshorja (atriumi) e djathtë
- C) Barkushja (ventrikula) e djathtë
- D) Barkushja (ventrikula) e majtë

Pyetja 154

Qarkullimi i madh i gjakut, te gjitarët, e merr fillimin nga:

- A) Veshorja (atriumi) e majtë
- B) Veshorja (atriumi) e djathtë
- C) Barkushja (ventrikula) e djathtë
- D) Barkushja (ventrikula) e majtë

Pyetja 155

Trombocitet kanë funksion:

- A) koagulues
- B) homeostatik
- C) transportojnë gaze
- D) prodhojnë antitropa

Pyetja 156

Në sistemin e dyfishtë të qarkullimit të gjakut, shkëmbimi i lëndëve ushqimore ndodh në nivelin e:

- A) arteriolave
- B) kapilarëve
- C) arterieve
- D) venave

Pyetja 157

Cila nga enët e mëposhtme të gjakut ka diametër maksimal?

- A) Vena
- B) Arteria
- C) Kapilari
- D) Arteriola

Pyetja 158

Molekula e hemoglobinës lidhet me O<sub>2</sub> në:

- A) mëlçi
- B) zemër
- C) veshka
- D) mushkëri

Pyetja 159

Vendi ku lokalizohet nyja sinoatriale është:

- A) veshorja (atriumi) e majtë
- B) veshorja (atriumi) e djathtë
- C) barkushja (ventrikula) e djathtë
- D) barkushja (ventrikula) e majtë

Pyetja 160

Shpërhapja(Difuzioni) nëpërmjet membranës plazmatike kryhet:

- A) kundër gradientit të përqendrimit
- B) sipas gradientit të përqendrimit
- C) me proteina transportuese
- D) me anën e receptorëve

Pyetja 161

Shpërhapja e joneve kundër gradientit të përqendrimit kryhet me ndihmën e:

- A) poreve qelizore të hapura
- B) poreve qelizore të mbushura me kolesterol
- C) proteinave specifike për një jon të caktuar
- D) proteinave të njëjta por që ndryshojnë formën

Pyetja 162

Antigjenet e sistemit A, B, O të grupit të gjakut janë:

- A) proteinat dhe lipidet
- B) enzimat e glikoproteinat
- C) proteinat dhe glikolipidet
- D) glikoproteinat dhe glikolipidet

Pyetja 163

Shpërhapja e lehtësuar ndihmohet nga proteinat bartëse. Ato gjatë punës ndryshojnë:

- A) formën
- B) masën
- C) sipërfaqen
- D) vëllimin

Pyetja 164

Osmoza është lëvizja e molekulave të ujit nëpërmjet membranave qelizore gjysmë të përshkueshme. Mund të themi se uji lëviz nga:

- A) tretësira e përqendruar drejtë tretësirës më të holluar
- B) tretësira më e holluar drejtë asaj më të përqendruar
- C) jashtë qelizës brenda saj
- D) brenda jashtë qelizës

Pyetja 165

Një eritrocit kur vendoset në një tretësirë hipotomike:

- A) fryhet dhe nuk plas
- B) ndodh hemoliza
- C) ruan formën e tij
- D) fryhet dhe plas



Pyetja 166

Kur bimës i hedhin kripë në tokë, qelizat e saj:

- A) ndodh plasmoliza
- B) nuk ndryshon
- C) çahet avola
- D) turgohen

Pyetja 167

Transporti aktiv është lëvizja e molekulave ose joneve:

- A) në drejtim të kundërt me gradientin e përqendrimit
- B) nëpërmjet membranave gjysmë të përshkueshme
- C) në përputhje me gradientin e përqendrimit
- D) që kërkon dhe ADP

Pyetja 168

Në një tretësirë të holluar qeliza bimore:

- A) çahet
- B) turgohet
- C) deformohet
- D) humbet në masë

Pyetja 169

Në një tretësirë hiperttonike qeliza shtazore:

- A) çahet
- B) tendoset
- C) rrudhoset
- D) nuk ndryshon formë

Pyetja 170

Në një qelizë të vendosur në tretësirë të holluar, uji futet brenda saj si rezultat i osmozës.

Shtypja që krijohet quhet:

- A) potencial i ujit
- B) potencial qetësie
- C) potencial veprimi
- D) shtypje osmotike

Pyetja 171

Në një tretësirë potenciali i ujit rritet si rezultat i rritjes së potencialit të:

- A) tretësirës
- B) veprimit
- C) shtypjes
- D) qetësisë

Pyetja 172

Në një tretësirë të holluar vendosim një copë patateje. Në këtë rast vrojtohet fenomeni i:

- A) çarjes
- B) turgorit
- C) plazmolizës
- D) ruajtjes së formës

Pyetja 173

Parameci është një organizëm njëqelizor heterotrof që jeton në ujërat e ëmbla. E vendosim paramecin në tretësirë hipotonike. Çfarë do të ndodhë me atë?

- A) Prania e murit qelizor nuk lejon të çahet
- B) Ruan formën që kishte më parë
- C) Fryhet e çahet
- D) Rrudhoset

Pyetja 174

Cilat nga qelizat e më poshtme kanë aftësinë të fagocitojnë?

- A) Qelizat e pankreasit
- B) Rruazat e kuqe
- C) Trombocitet
- D) Makrofagët

Pyetja 175

Transporti me ndërmjetësinë e receptorëve ndodh si më poshtë:

- A) molekulat lidhen me pompa
- B) molekulat kalojnë përmes poreve qelizore
- C) molekulat përfshihen nga receptorët brenda qelizor
- D) molekulat përfshihen nga receptorët transmembranorë

Pyetja 176

Kariesi dentar mund të parandalohet:

- A) duke ngrënë ushqime me bazë yndyrore
- B) duke marrë më shumë fruta në dietë ushqimore
- C) duke patur një dietë ushqimore të pasur me perime
- D) duke patur një dietë ushqimore të varfër me sheqerna

Pyetja 177

Në saj të veprimit të tëmthit:

- A) treten yndyrnat
- B) treten proteinat
- C) pikat e vogla të yndyrës bashkohen në pika të mëdha
- D) pika e mëdha të yndyrës copëtohen në pjesë të vogla

Pyetja 178

Elementet gypëzore të floemës quhen gypëza me fund:

- A) të hapur
- B) të mbyllur
- C) shoshë
- D) membranor

Pyetja 179

Qelizat shoshe dallojnë nga qelizat shoqëruese sepse:

- A) nuk kanë citoplazmë
- B) nuk kanë rrjet endoplazmatik
- C) nuk kanë mur qelizor
- D) nuk kanë bërthamë aktive

Pyetja 180

Qelizat shoshe dallojnë nga qelizat e ksilemës sepse:

- A) janë qeliza të vdekura
- B) janë qeliza të gjalla
- C) nuk kanë mur qelizor
- D) kanë mur qelizor

Pyetja 181

Qelizat shoshe lidhen me qelizat shoqëruese përmes:

- A) plazmodezmave
- B) brezit të Kasparit
- C) fibrave
- D) sklerideve

Pyetja 182

Te bimët jonet kalojnë nga toka tek rrënjët me anë të:

- A) osmozë
- B) kotransport
- C) transportit aktiv
- D) difuzion i lehtësuar

Pyetja 183

Transporti i molekulave të sakarozës, për në qelizat shoqëruese është një shembull i:

- A) transportit të lehtësuar
- B) transportit aktiv
- C) kotransportit
- D) difuzionit

Pyetja 184

Humbja e ujit nga gjethja në mjedis bëhet përmes:

- A) kutikulës
- B) gojëzave
- C) epidermës së sipërme
- D) parenkimës gardhore

Pyetja 185

Forca përgjegjëse për ngjitjen e ujit në gypat e ksilemës është:

- A) forca e kohezion-tensionit
- B) forca thithëse që ushtrojnë gjethet
- C) forca shtytëse që ushtrojnë rrënjët
- D) forca shtytëse e gypave të ksilemës

Pyetja 186

Lënda organike në floemë rrjedh:

- A) ditën edhe natën
- B) vetëm gjatë ditës
- C) vetëm gjatë natës
- D) vetëm në prani të dritës

Pyetja 187

Nëse në një gyp ksileme do të fusim ajër, atëherë kolona e ujit në ksilemë:

- A) ndërpritet
- B) ndërpritet pjesërisht
- C) vazhdon të ngjitet lart
- D) vazhdon të lëvizë vetëm poshtë

Pyetja 188

Njëri nga hormonet më poshtë ndikon në shumë aspekte të rritjes bimore.

Ky hormon është:

- A) acetamina
- B) anilina
- C) auksina
- D) atropina

Pyetja 189

Njëri nga hormonet më poshtë përfshihet më shumë në mbirjen e farës dhe kontrollon zgjatjen e kërcellit. Ky hormon është:

- A) acidi abshisik (ABA)
- B) citokinina
- C) giberelina
- D) auksina

Pyetja 190

Njëri nga hormonet më poshtë kontrollon ndarjen qelizore. Ky hormon është:

- A) acidi abshisik (ABA)
- B) citokinina
- C) giberelina
- D) auksina

Pyetja 191

Njëri nga hormonet më poshtë kontrollon përgjigjen e bimës ndaj kushteve ekstreme si mungesa e ujit. Ky hormon është:

- A) acidi abshisik (ABA)
- B) citokinina
- C) giberelina
- D) auksina

Pyetja 192

Gjatë një stërvitje intensive, në muskuj prodhohet një përbërje që ndryshon vlerën e pH-it, të gjakut. Cila është kjo përbërje?

- A) Azoti
- B) Oksigjeni
- C) Acid laktik
- D) Alkooli etilik

Pyetja 193

Cila është rruga e saktë e kalimit të ajrit për në mushkëri?

- A) Zgavra e hundës – Laringu – Trakea – Bronket – Bronkiola – Alveola
- B) Zgavra e hundës – Laringu – Faringu – Bronket – Bronkiola – Alveola
- C) Zgavra e hundës – Laringu – Ezofagu – Trakea – Bronket – Bronkiola – Alveola
- D) Zgavra e hundës – Faringu – Laringu – Trakea – Bronket – Bronkiola – Alveola

Pyetja 194

Çfarë ndodh me frymëmarrjen te njerëzit gjatë sforcimit fizik?

- A) Thellësia e frymëmarrjes rritet dhe ritmi i frymëmarrjes përshpejtohet
- B) Shpejtësia e frymëmarrjes rritet, por jo thellësia e frymëmarrjes
- C) Thellësia e frymëmarrjes ulet dhe ritmi i frymëmarrjes ulet
- D) Thellësia e frymëmarrjes rritet, por jo ritmi i frymëmarrjes

Pyetja 195

Shkëmbimi i gazeve në nivelin mushkëror realizohet nëpërmjet:

- A) bronkeve dhe gjakut
- B) bronkiolave dhe gjakut
- C) indit mushkëror dhe gjakut
- D) alveolave dhe kapilarëve mushkëror

Pyetja 196

Mushkëritë nuk fërkohen me kafazin e kraharorit sepse:

- A) mbrohen nga kafazi i kraharorit
- B) mbështillen nga diafragma
- C) mbështillen nga pleura
- D) mbrohen nga brinjët

Pyetja 197

Fibrat elastike të cilat mblidhen gjatë procesit të frymënxjerrjes dhe tendosen gjatë procesit të frymëthithjes ndodhen në muret e:

- A) trakesë
- B) bronkeve
- C) laringut
- D) alveolave

Pyetja 198

Rrugët e ajrit tek gjitarët qëndrojnë vazhdimisht të hapura për shkak të:

- A) indit lidhor
- B) indi tepitelial
- C) unazave kërcore
- D) unazave kockore

Pyetja 199

Mushkëritë janë organe çifte, në brendësi të tyre ndodhen:

- A) alveolave dhe bronket
- B) alveolave dhe bronkiolat
- C) bronket dhe bronkiolat
- D) trakea dhe bronket

Pyetja 200

Gjatë frymëthithjes:

- A) muskujt ndërbrinjor të jashtëm tkurren
- B) muskujt ndërbrinjorë të jashtëm lëshohen
- C) diafragma ngrihet lart
- D) brinjët ulen poshtë

Pyetja 201

Gjatë frymënxjerrjes:

- A) brinjët ngrihen lart
- B) diafragma ulet poshtë
- C) muskujt ndërbrinjorë të jashtëm tkurren
- D) muskujt ndërbrinjorë të jashtëm lëshohen

Pyetja 202

Në sistemin e ajrosjes(ventilimit) tek gjitarët përfshihen:

- A) diafragma dhe alveola
- B) bronkiolat dhe alveolat
- C) muskujt ndërbrinjorë dhe diafragma
- D) muskujt ndërbrinjorë dhe alveola

Pyetja 203

Ajri që thithim përmban:

- A) 78% oksigjen, 21% azot, 1% gaze të tjera
- B) 78% azot, 21% oksigjen, 1% gaze të tjera
- C) 78% oksigjen, 21% azot, 1% dioksid karboni
- D) 78% azot, 21% oksigjen, 1% monoksid karboni

Pyetja 204

Funksioni kryesor i tëmthit është:

- A) emulgimi i lipideve
- B) të derdhë lëngun e tëmlit në stomak
- C) krijon kushte për veprimin e amilazës
- D) krijimi i kushteve për veprimin e insulinës

Pyetja 205

Cili prej grupeve ushqimore të mëposhtme nxit lëvizjen peristaltike të zorrës?

- A) Karbohidratet
- B) Vitaminat
- C) Proteinat
- D) Fibrat

Pyetja 206

Tripsina është enzimë e cila zbërthen në duoden:

- A) proteinat
- B) yndyrnat
- C) laktozën
- D) amidonin

Pyetja 207

Në cilën pjesë të gypit tretës e kryen veprimin lipaza?

- A) Gojë
- B) Ezofag
- C) Stomak
- D) Duoden

Pyetja 208

Sindroma e kequshqyerjes që shkaktohet nga mungesa e aminoacideve esenciale në dietë quhet:

- A) Sindroma Kwashiorker
- B) Sindroma Marasman
- C) Sindroma Edwards
- D) Sindroma Patau

Pyetja 209

Lëngu i cili prodhohet nga muret e stomakut quhet:

- A) lëngu pankreatik
- B) lëngu gastrik
- C) lëngu biliar
- D) lëngu sinovial

Pyetja 210

Enzima, e cila zbërthen proteinat në zinxhirë më të shkurtër polipeptidikë është:

- A) lipaza
- B) amilaza
- C) maltaza
- D) pepsina

Pyetja 211

Unaza muskulore, e cila lejon kalimin e ushqimit nga stomaku në duoden quhet:

- A) sfinkteri kardiak
- B) sfinkteri ileocekal
- C) sfinkteri pilorik
- D) sfinkteri parakapilar

Pyetja 212

Stomaku është një organ i rëndësishëm jetësor i cili shërben për:

- A) ruajtjen e ushqimit dhe tretjen e lipideve
- B) ruajtjen e ushqimit dhe tretjen e yndyrnave
- C) ruajtjen e ushqimit dhe tretjen e karbohidrateve
- D) denatyrimin dhe tretjen e pjesshme të proteinave

Pyetja 213

Përpunimi mekanik i ushqimeve realizohet në:

- A) gojë dhe ezofag
- B) gojë dhe stomak
- C) stomak dhe zorrën e trashë
- D) stomak dhe zorrën e hollë

Pyetja 214

Zbërthimi i plotë i proteinave bëhet në:

- A) zorrën e trashë
- B) zorrën e hollë
- C) stomak
- D) ezofag

Pyetja 215

Proteina kryesore e pështymës është:

- A) mukusi
- B) mucina
- C) pepsina
- D) proteaza

Pyetja 216

Pankreasi është gjëndër me sekrecion të dyfishtë. Si gjëndër ekzokrine pankreasi prodhon:

- A) hormonet insulinë dhe glukagon
- B) enzima dhe acid klorhidrik
- C) enzima dhe bikarbonate
- D) hormone dhe enzima

Pyetja 217

Gjatë gjellitjes së ushqimeve frymëmarrja ndërpritet sepse masa ushqimore:

- A) hap trakenë
- B) ul epiglotën
- C) ngre epiglotën
- D) mbyll ezofagun

Pyetja 218

Palca e kuqe kockore është vendi ku:

- A) eliminohen agjentët patogjenë
- B) prodhohen qelizat e gjakut
- C) prodhohet histamina
- D) prodhohet albumina

Pyetja 219

Antitruapat që qarkullojnë në gjak quhen:

- A) limfocite
- B) eozinofile
- C) glikoproteina
- D) imunoglobulina

Pyetja 220

Imuniteti qelizor i detyrohet :

- A) imunoglobulinave
- B) limfociteve B
- C) limfocitetve T
- D) makrofagëve



Pyetja 221

Sëmundjet infektive shkaktohen nga:

- A) kequshqyerja
- B) mutacionet e gjeneve
- C) çrregullimet hormonale
- D) viruset dhe bakteret patogjenë

Pyetja 222

Përgjigja imunitare specifike sigurohet nga:

- A) limfocitet B dhe T
- B) makrofagët
- C) neutrofilet
- D) fagocitet

Pyetja 223

Fagocitet sigurojnë mbrojtje:

- A) jospecifike dhe specifike
- B) nuk kanë rol mbrojtës
- C) jospecifike
- D) specifike

Pyetja 224

Fagocitet i njohin lëndë e prodhuara nga patogjenët përmes receptorëve:

- A) bërthamorë
- B) citoplazmikë
- C) membranorë
- D) jashtëqelizorë

Pyetja 225

Përgjigja imunitare jospecifike drejtohet:

- A) vetëm ndaj infeksioneve kërpudhore
- B) ndaj të gjithë llojeve të infeksioneve
- C) vetëm ndaj infeksioneve bakteriale
- D) vetëm ndaj infeksioneve virale

Pyetja 226

Imuniteti humoral është i lidhur vetëm me:

- A) limfocitet B
- B) limfocitet T
- C) makrofagët
- D) neutrofilet

Pyetja 227

Veprimi i qelizave T është më efektiv kundër:

- A) viruseve
- B) baktereve
- C) kërpudhave
- D) protozoarëve

Pyetja 228

Përgjigja e parë imunitare sigurohet nga antitruapat e prodhuar nga:

- A) qelizat e kujtesës
- B) qelizat plazmatike
- C) qelizat makrofage
- D) qelizat monocite

Pyetja 229

Një nga këto përbërës testohet në gjak për të përcaktuar nëse një person është i infektuar nga një virus në të kaluarën:

- A) Antigjenet
- B) Antitruapat
- C) Makrofagët
- D) Patogjenët

Pyetja 230

Nëse në gjakun e një kavje injektojmë glukozë, atëherë sasia e glukagonit:

- A) rritet
- B) pakësohet
- C) nuk ndryshon
- D) herë ulet e herë ngrihet

Pyetja 231

Reagimi i sistemit nervor ndaj ndryshimit të parametrave homeostatikë është:

- A) i njëjtë me atë të sistemit hormonal
- B) më i shpejtë se ai i sistemit hormonal
- C) më i ngadaltë se ai i sistemit hormonal
- D) më i shpejtë se ai i sistemit tretës

Pyetja 232

Pankreasit është gjëndër:

- A) vetëm ekzokrine
- B) vetëm endokrine
- C) neuroekzokrine
- D) ekzokrine dhe endokrine

Pyetja 233

Qelizat  $\alpha$  të pankreasit prodhojnë:

- A) insulinë
- B) glukagon
- C) adrenalinë
- D) noradrenalinë

Pyetja 234

Qelizat  $\beta$  të pankreasit prodhojnë:

- A) insulinë
- B) glukagon
- C) adrenalinë
- D) noradrenalinë

Pyetja 235

Kontrolli i potencialit uhor në mjedisin e brendshëm të organizmit quhet:

- A) ekzorregullim
- B) osmorregullim
- C) termorregullim
- D) vetërregullim

Pyetja 236

Qelizat shenjë për hormonin ADH ndodhen në:

- A) glomerulë
- B) gypin mbledhës
- C) gypin proksimal
- D) kupën e Baumanit

Pyetja 237

Rënia e potencialit të ujit në gjak “perceptohet” nga:

- A) baroreceptorët
- B) kimiorreceptorët
- C) mekanoreceptorët
- D) osmoreceptorët

Pyetja 238

Nisur nga sinjalet e osmoreceptorëve, hipotalamusi prodhon hormonin:

- A) antidiuretik
- B) kortizolin
- C) oksitocinën
- D) prolaktinën

Pyetja 239

Hormoni antidiuretik që vepron në qelizat e gypit të nefronit nxit ripërthithjen:

- A) e natriumit
- B) e kaliumit
- C) e glukozës
- D) e ujit

Pyetja 240

Nëse një individ ka pirë shumë ujë, atëherë sasia e hormonit antidiuretik që çlirohet në gjak:

- A) rritet
- B) zvogëlohet
- C) dyfishohet
- D) nuk ndryshon

Pyetja 241

Nëse temperatura trupore te njeriu ulet nën  $36^{\circ}\text{C}$ , atëherë:

- A) muskujt skeletor do të tkurren
- B) muskujt skeletor do të lëshohen
- C) gjëndrat e djersës do të aktivizohen
- D) gjëndrat e pështymës do të inaktivizohen

Pyetja 242

Kur temperatura trupore te njeriu rritet mbi 37°C, atëherë:

- A) muskujt e lëmuar do të tkurren
- B) muskujt e lëmuar do të lëshohen
- C) gjëndrat e djersës do të aktivizohen
- D) gjëndrat e pështymës do të inaktivizohen

Pyetja 243

Nëse bën nxehtë, trupi e rregullon temperaturën përmes parimit feedback negativ duke:

- A) zgjeruar enët e gjakut
- B) ngushtuar enët e gjakut
- C) mos ndryshuar diametri i enëve të gjakut
- D) ndryshuar diametri i enëve limfatike

Pyetja 244

Në bashkërendimin e punës së organeve të ndryshëm, marrin pjesë:

- A) sistemi endokrin dhe muskolor
- B) sistemi muskolor dhe skeletor
- C) sistemi nervor dhe endokrin
- D) sistemi nervor dhe muskolor

Pyetja 245

Në kushte qetësie përqendrimi i joneve Na<sup>+</sup> tek neuroni është:

- A) më i madh jashtë qelizës
- B) më i vogël jashtë qelizës
- C) më i madh brenda qelizës
- D) i njëjtë në të dyja anët e membranës

Pyetja 246

Në kushte qetësie përqendrimi i joneve K<sup>+</sup> tek neuroni është:

- A) i njëjtë në të dyja anët e membranës
- B) më i madh brenda qelizës
- C) më i vogël brenda qelizës
- D) më i madh jashtë qelizës

Pyetja 247

Lënda gri përbëhet nga:

- A) aksonet e neuroneve
- B) dentritet e neuroneve
- C) butonet e neuroneve
- D) trupat e neuroneve

Pyetja 248

Në palcën kurrizore lënda gri:

- A) ndodhet në periferi me formën e shkronjës H
- B) ndodhet në qendër, në formën e shkronjës H
- C) është e përzierë me lëndën e bardhë
- D) përbëhet nga aksonet e neuroneve

Pyetja 249

Neuronet e ndërmjetme transmetojnë impulse nga:

- A) receptori në neuronet ndijore
- B) neuroni ndijor në neuronin lëvizor
- C) neuroni lëvizor drejt organit efektor
- D) një neuron lëvizor në një neuron të ndërmjetëm

Pyetja 250

Neuroni ndijor e transmeton sinjalin nervor nga:

- A) receptori në SNQ
- B) SNQ te receptori
- C) SNQ te organi efektor
- D) organi efektor te SNQ

Pyetja 251

Gjatë potencialit të membranës në qetësi, membrana e neuronit është e ngarkuar:

- A) pozitivisht në të dyja anët e membranës
- B) negativisht në të dyja anët e membranës
- C) pozitivisht nga brenda në raport me jashtë
- D) negativisht nga brenda në raport me jashtë

Pyetja 252

Ripolarizimi i membranës së neuronit pas veprimit të një ngacmuesi bëhet pasi vala depolarizuese ka mbërritur:

- A) në fund të aksonit të neuronit
- B) në mes të aksonit të neuronit
- C) nga zona e ngacmuar në zonën fqinje
- D) në treçerekun e gjatësisë së aksonit

Pyetja 253

Shpejtësia e transmetimit të valës depolarizuese është:

- A) më e vogël në aksonet me mielinë
- B) më e madhe në aksonet pa mielinë
- C) më e madhe në aksonet me mielinë
- D) e barabartë në të dyja llojet e aksoneve

Pyetja 254

Cila prej alternativave përgjigjet për përcjelljen me kërcim të neuroneve me mielinë:

- A) forma e trupit qelizor
- B) gjatësia e aksonit
- C) forma e dentriteve
- D) nyjet e Ranvje

Pyetja 255

Është strukturë neurohormonale:

- A) hemisfera e majtë e trurit
- B) hemisfera e djathtë e trurit
- C) hipotalamusi
- D) truri i vogël

Pyetja 256

Qendrat e etjes dhe të urisë gjendet në:

- A) hipofizë
- B) hipotalamus
- C) trurin e vogël
- D) trurin e madh

Pyetja 257

Trupat e neuroneve formojnë në palcën kurrizore:

- A) lëndën e bardhë
- B) lëndën gri
- C) lëndën e kuqe
- D) lëndën e verdhë

Pyetja 258

Cila nga sa vijon është sekuenca e saktë në të cilën urina rrjedh nëpër veshka drejt fshikëzës urinare?

- A) Legeni renal, Kaliksi i madh, Kaliksi minor, Duktusi papilar, Ureteri
- B) Dukt papilar, Kaliksi minor, Kaliksi i madh, Legen renal, Ureteri
- C) Kaliksi minor, Kaliksi madh, Duktusi papilar, Legeni renale, Ureteri
- D) Dukt papilar, Kaliks madhor, Kalik minor, ureter, Legen renale

Pyetja 259

Cili nga pohimet e mëposhtme në lidhje me ureterët është i rremë?

- A) Mukoza e çdo ureteri është e përbërë nga epitel kalimtar
- B) Ato përbëhen nga tre tunika
- C) Valët peristaltike muskulare lëvizin urinën nëpër uretere
- D) Janë të vendosura brenda kavitetit peritoneal

Pyetja 260

Të gjitha pohimet e mëposhtme janë të vërteta në lidhje me uretrën e 1 mashkulli, PËRVEÇ:

- A) përmban një sfinkter të vetëm uretral pranë qafës së fshikëzës urinare
- B) i shërben si sistemit urinar ashtu edhe atij riprodhues
- C) merr sekrecione nga gjëndrat bulbouretrale
- D) përbëhet nga tre rajone të dallueshme

Pyetja 261

Presioni hidrostatik kapilar gjatë filtrimit në glomerulë i detyrohet:

- A) madhësisë të kapsulës së Bauman-it
- B) formës si kupë të kapsulës Bauman-it
- C) një arteriol aferent është i ngushtë në krahasim me eferentin
- D) një arteriol eferent që është i ngushtë në krahasim me aferentin

Pyetja 262

NUK është pjesë e një piramide renale:

- A) laku Henle
- B) gypi i përdredhur
- C) dukti përmbledhës
- D) kapilarët peritubularë

Pyetja 263

Riabsorbimi maksimal i joneve  $\text{Na}^+$  dhe  $\text{K}^+$  ndodh në:

- A) në lakun e Henlit
- B) në kapsulën e Baumanit
- C) në tubin e përdredhur distal
- D) në tubin e përdredhur proksimal

Pyetja 264

Në rast të marrjes të një sasisë të vogël të lëngjeve:

- A) hipotalamusi prodhon më shumë hormon ADH
- B) urina është më pak e përqendruar
- C) veshka kthen më pak ujë në gjak
- D) rritet prodhimi i urinës

Pyetja 265

Cili nga pohimet shpjegon SAKTE funksionin e një pjese specifike të nefronit:

- A) arteriol aferent-largon gjakun nga glomerula drejt venës renale
- B) tubula e përdredhur distale-riabsorbimi i joneve  $\text{K}^+$  në kapilarët e gjakut përreth
- C) laku Henle-shumica e riabsorbimit të substancave kryesore nga filtrati glomerular
- D) podocitet-krijojnë hapësira të vogla për filtrimin e gjakut në kapsulën Bauman

Pyetja 266

Riorganizoni pjesët e mëposhtme të një nefroni bazuar në rrjedhën e lëngut brenda tyre.

1. Tubi i përdredhur distal
2. Kapsula e Baumanit
3. Laku i Henlit
4. Tubi mbledhës
5. Tubi i përdredhur proksimal

- A) 5, 3, 1, 2, 4
- B) 3, 5, 1, 2, 4
- C) 2, 1, 5, 3, 4
- D) 2, 5, 3, 1, 4

Pyetja 267

Cila pjesë e nefronit ndihmon në ruajtjen e pH-it të lëngjeve të trupit duke thithur  $\text{HCO}_3^-$  nga filtrati?

- A) tubi i përdredhur proksimal
- B) tubi distal i përdredhur
- C) kanali grumbullues
- D) laku i Henlit

Pyetja 268

Sasia maksimale e ujit nga filtrati glomerular riabsorbohet nga:

- A) tubi i përdredhur proksimal
- B) pjesa zbritëse e lakut Henle
- C) pjesa ngjitëse e lakut Henle
- D) tubi distal i përdredhur

Pyetja 269

Cilat janë funksionet e veshkës?

- A) Ekskretimi i ures dhe ruajtja e balancës së ujit
- B) Ripërthithja dhe filtrimi
- C) Sekretimi dhe ripërthithja
- D) Ripërthithje, Sekretim, Filtrim

Pyetja 270

Ureja:

- A) prodhohet në veshkë dhe eliminohet po nga veshka
- B) prodhohet në veshkë dhe eliminohet nga mëlçia
- C) prodhohet në mëlçi dhe eliminohet nga veshka
- D) prodhohet në mëlçi dhe rezervohet në organizëm

Pyetja 271

Në gjatësinë e lakut të Henlit:

- A) ripërthithen nga tubi në gjak NaCl dhe uji
- B) sekretohen në tub substanca helmuese
- C) dalin jashtë nga tubi molekulat e ujit me transport aktiv
- D) kalimi i ujit jashtë tubit rregullohet me rruge hormonale

Pyetja 272

Urina formohet si pasojë e:

- A) filtrimit glomerular
- B) vetëm riabsorbimit tubular
- C) vetëm sekretimit tubular
- D) filtrim glomerular, riabsorbimit dhe sekretimit tubular

Pyetja 273

Filtrati i mbetur pas riabsorbimit tubular dhe sekretimit quhet:

- A) kreatinin
- B) acid urik
- C) urinë
- D) ure

Pyetja 274

Amoniaku është një përbërje toksike dhe shumë e tretshme. Ai:

- A) kalon duke u shndërruar menjëherë në gjak
- B) kalon pa u shndërruar menjëherë në gjak
- C) bashkohet me CO<sub>2</sub> për të formuar uren
- D) formon uren

Pyetja 275

Ngjyra e verdhë e urinës i detyrohet pranisë së:

- A) uresë
- B) acidit urik
- C) urokromit
- D) melaninës



Pyetja 276

Akuaporinat(kanalet e ujit) janë përgjegjëse për ndryshimin e përshkueshmërisë së tij.

Ato gjenden në:

- A) korteks
- B) glomerul
- C) kapsulën e Bauman-it
- D) membranën plazmatike të gypave mbledhës

Pyetja 277

Zona mediale konkave e veshkës njihet si:

- A) piramida
- B) ureteri
- C) legen
- D) hilus

Pyetja 278

Cili nga funksionet/strukturat e mëposhtme NUK është i lidhur me nefronin?

- A) Prodhimi i uresë
- B) Riabsorbimi selektiv
- C) Laku i Henlit
- D) Ultrafiltrim

Pyetja 279

Katër veprimet e mëposhtme ndodhin gjatë procesit të riprodhimit seksual te bimët me lule.

Bëni radhitjen e saktë të këtyre veprimeve:

- 1 Kokrrat e pjalmmit bien mbi krezën e pistilit.
- 2 Gameti mashkullor bashkohet me gametin femëror.
- 3 Gameti mashkullor udhëton përgjatë gypit pjalmik.
- 4 Gypi pjalmik fillon të rritet.

Në çfarë rendi ndodhin këto procese?

- A) 3, 4, 1, 2
- B) 4, 3, 2, 1
- C) 1, 4, 3, 2
- D) 1, 2, 4, 3

Pyetja 280

Lulet e gramit janë me petale ngjyrë të gjelbër. Ajo është bimë që pjalmohet me anë të erës.

Cili rresht i tabelës tregon një dallim të saktë ndërmjet luleve që pjalmohen me anë të erës dhe luleve që pjalmohen me anë të insekteve?

	Lule që pjalmohet me anë të insekteve	Lule që pjalmohet me anë të erës
A)	Pistil me shtyllëz të shkurtër	Pistil me shtyllëz të gjatë
B)	Prania e thekëve dhe pistilit në të njëjtën lule	Lulet kanë vetëm thekë ose vetëm pistil.
C)	Mungojnë qelizat që prodhojnë nektar	Të pranishme qeliza që prodhojnë nektar
D)	Prodhojnë sasi të madhe kokrrizash pjalmi të lehta dhe të lëmuara	Prodhojnë sasi të vogël kokrrizash pjalmi ngjitëse

Pyetja 281

Cili rresht në tabelë tregon funksionet e duhura të luleve që pjalmohen prej insekteve?

A)	Anterat prodhojnë kokrrat e pjalmimit	Pistila përmban ovulat	Insektet ulen te kurora
B)	Nënpetlat tërheqin insektet	Ovulat prodhohen në anterë	Ovulat ndodhen në muret e shtratit të lules
C)	Mbi krezë bien kokrrat e pjalmimit	Vezoret përmbajnë vezët	Thekët prodhojnë kokrrat e pjalmimit
D)	Petalet kanë rol mbrojtës për lulen	Pistili është vendi ku ndodh pjalmimi	Antera prodhon vezët


Pyetja 282

Cila nga mënyrat e mëposhtme konsiderohet si formë natyrore e klonimit?

- A) Kryqëzimi i bimëve të varieteteve të ndryshme
- B) Kryqëzimi i bimëve të të njëjtit varietet
- C) Riprodhimi me tubere
- D) Vetëpjalmimi

Pyetja 283

Figura e mëposhtme tregon fazat e riprodhimit te njeriu. Rezultati i fekondimit është paraqitur në strukturën:



- A) A
- B) B
- C) C
- D) D

Pyetja 284

Binjakët e një veze formohen nga bashkimi i një veze me sa spermatozoide?

- A) 4
- B) 3
- C) 2
- D) 1


Pyetja 285

Cila lëndë kalon zakonisht në sasi më të madhe nëpërmjet placentës nga gjaku i fetusit në gjakun e nënës?

- A) Aminoacidet
- B) Dioksid karboni
- C) Glukozë
- D) Oksigjen

Pyetja 286

Procesi i ndarjes mejotike të qelizave fillon brenda strukturës:



- A) 1
- B) 2
- C) 3
- D) 4

Pyetja 287

Pas pllenimit në vezë ndodhin tre ndryshime, PËRVEÇ:

- A) vezikulat kortikale derdhin përmbajtjen në zonën pellucide të vezës, e cila mbyllet hermetikisht
- B) ovociti sekondar i nënshtrohet ndarjes së dytë mejotike dhe jep vezën dhe trupin tjetër polar
- C) ovociti primar i nënshtrohet ndarjes së parë mejotike dhe jep ovocitin sekondar dhe trupin polar
- D) ndodh shkrirja e bërthamës së vezës me bërthamën e spermatozoidit (kariogamia)


Pyetja 288

Në qoftë se cikli është konkretizuar me fekondim, trupi i verdhë:

- A) ngelet funksional gjatë gjithë kohës së shtatzënisë
- B) ngelet funksional deri në tremestrin e dytë
- C) ngelet funksional deri në tremestrin e parë
- D) shkatërrohet pas fekondimit

Pyetja 289


Figura e mëposhtme tregon aparatit riprodhues femëror të njeriu. Cila prej strukturave të mëposhtme çliron estrogenin në sistemin e qarkullimit të gjakut?



- A) 1
- B) 2
- C) 3
- D) 4

Pyetja 290

Cili nga çiftet e gametëve, kur bashkohen, çojnë në formimin e një zigote e cila do të zhvillohet në një embrion normal mashkullor?



- A) I
- B) II
- C) III
- D) IV

Pyetja 291

Estradioli është i domosdoshëm për:

- A) formimin e gametëve femërore – diferencimin e rrugëve gjinore – rritjen e përmasave të gametit femëror
- B) diferencimin e tipareve dytësore seksuale – diferencimin e rrugëve gjinore – rritjen e përmasave të gametit femëror
- C) formimin e gametëve femërore – diferencimin e tipareve dytësore seksuale – diferencimin e rrugëve gjinore
- D) formimin e gametëve femërore – diferencimin e tipareve dytësore seksuale – rritjen e përmasave të gametit femëror

Pyetja 292

Cili nga kombinimet e mëposhtme është i saktë lidhur me prodhimin dhe sekretimin e hormoneve?

- A) Pjesa ekzokrine e pankreasit – hipofizë
- B) Gjëndrat tiroide – gjëndrat e pështymës
- C) Hipofizë – gjëndrat e pështymës
- D) Hipofizë – gjëndra tiroide

Pyetja 293

Cilat nga gjëndrat e mëposhtme prodhon hormone homeostatike?

- A) Hipofizë
- B) Gjendra mbiveshkore
- C) Pjesa ekzokrine e pankreasit
- D) Gjëndrat paratiroide

Pyetja 294

Kur receptorët e lëkurës ngacmohen nga rritja e temperaturës së mjedisit ndodh:

- A) ngushtimi i enëve të gjakut të sipërfaqes
- B) shtimi i sekretimit të adrenalinës
- C) pakësimi i prodhimit të djersës
- D) shtimi i prodhimit të djersës

Pyetja 295

Adenohipofiza NUK prodhon:

- A) FSH
- B) prolaktinë
- C) ADH
- D) LH

Pyetja 296

Cili nga kombinimet e mëposhtme është plotësisht i saktë lidhur me prodhimin e hormoneve?

- A) Hipofiza, Vezoret, Neurohipofiza, Pankreasi dhe Gjëndrat e pështymës
- B) Hipofiza, Tiroide, Vezore, Gjëndër pështyme, Gjëndrat e djersës
- C) Hipofiza, Gjëndrat e qumështit, Tiroide, Vezore, Neurohipofiza
- D) Vezore, Tiroide, hipofiza, Hipotalamus, Pankreas

Pyetja 297

Kimiorceptorët në bulbet e shijes që gjenden në gjuhë nxiten nga:

- A)  $Ca^{2+}$
- B)  $Na^+$
- C)  $K^+$
- D) AMP ciklike

Pyetja 298

Hormonet me natyrë peptidike nuk mund të kalojnë membranën dyshtresore fosfolipidike.

Cila nga hormonet e mëposhtme NUK bën pjesë në këtë grup?

- A) Adrenalina
- B) Glukagoni
- C) ADH-ja
- D) Estrogjeni

Pyetja 299

Cikli menstrual koordinohet nga:

- A) sekretimi i hormonit progesteron
- B) sekretimi i hormonit FSH
- C) hormonet me natyrë glukoproteinike dhe nga vezoret
- D) vetëm sekretimi i hormonit estrogen

Pyetja 300

Hormoni kundër urinimit(ADH) sekretohet nga \_\_\_\_\_ dhe vepron në \_\_\_\_\_.

Cili çiftim është i saktë?

- A) Hipotalamus – Aparat tretës
- B) Mbiveshkore – Zorrë e trashë
- C) Adenohipofizë – Zorrë e hollë
- D) Neurohipofizë – Veshkë

Pyetja 301

Hormoni FSH dhe LH prodhohen nga \_\_\_\_\_ dhe veprojnë në \_\_\_\_\_:

- A) hipotalamus – mitër
- B) gjendër mbiveshkore – gyp fallopi
- C) adenohipofizë – vezore
- D) neurohipofizë – ovidukt

Pyetja 302

Hormoni GH prodhohet në \_\_\_\_\_ dhe vepron në \_\_\_\_\_:

- A) hipotalamus – muskuj të lëmuar + skelet
- B) tiroide – lëkurë + skelet
- C) neurohipofizë – muskuj të lëmuar + muskuj të vijëzuar
- D) adenohipofizë – muskuj e skeletit

Pyetja 303

Prolaktina është një hormon i rëndësishëm tek femra.

Ai prodhohet nga \_\_\_\_\_ dhe ka rol në \_\_\_\_\_:

- A) hipotalamus – dalje qumështi
- B) adenohipofiza – prodhim qumështi + zhvillim gjiri
- C) neurohipofiza – në zhvillim cikli
- D) gjëndrat mbiveshkore – të gjitha

Pyetja 304

Estradioli është hormoni që prodhohet nga \_\_\_\_\_, të \_\_\_\_\_:

- A) tiroide – trupi i verdhë
- B) qelizat folikulare – vezores
- C) hipotalamus – shtresa e brendshme
- D) hipofizë – shtresa e kores

Pyetja 305

Gjëndrat mbiveshkore prodhojnë hormonet \_\_\_\_\_ që ndikojnë \_\_\_\_\_:

- A) adrenalinë dhe prolaktinë – përqindje glicemie
- B) adrenalinë, noradrenalinë dhe oksitocinë – të gjitha
- C) adrenalinë, oksitocinë dhe kortizol – përthithje uji
- D) adrenalinë, noradrenalinë, kortizol – gjendjen emocionale dhe nivelin e sheqerit

Pyetja 306

Testosteroni prodhohet nga testikuli i nxitur nga:

- A) neurohipofiza
- B) tiroidja
- C) paratiroidja
- D) adenohipofiza

Pyetja 307


Gjatë tkurrjes së muskujve të këmbëve gjaku në vena ngjitet lart përmes:

- A) nyjes sinoatriale
- B) valvula bikuspide
- C) valvula trikuspide
- D) valvula në formë xhepi

Pyetja 308

Në diagramën e mëposhtme valvula trikuspidale identifikohet me numrin:

- A) 1
- B) 2
- C) 3
- D) 4



Pyetja 309

Gjaku që kthehet nga qarkullimi i madh i gjakut është:

- A) i pasur me dioksid karboni
- B) i pasur me oksigjen
- C) i varfër me dioksid karboni
- D) i varfër me glukozë

Pyetja 310

Gjaku që kthehet nga qarkullimi i vogël i gjakut është:

- A) i pasur me dioksid karboni
- B) i pasur me oksigjen
- C) i varfër me oksigjen
- D) i pasur me glukozë

Pyetja 311

Cila nga enët e gjakut karakterizohet nga elasticiteti i lartë në muret e saj?

- A) Vena
- B) Kapilar
- C) Aorta
- D) Venulat

Pyetja 312

Membrana e hollë e cila përbëhet nga një ind lidhës, përmasat e të cilit i lejojnë zemrës të ndryshojë vëllimin e saj në fazat e ndryshme të ciklit kardiak quhet:

- A) pleura
- B) perikardi
- C) miokardi
- D) septum

Pyetja 313

Gjatë systoles ventrikulare(barkusheve) gjaku ndjek rrugën:

- A) barkushe – arterie
- B) veshore – barkushe
- C) barkushe – veshore
- D) arterie – barkushe

Pyetja 314

Gjatë systoles atriale(veshoreve) gjaku ndjek rrugën:

- A) barkushe – veshore
- B) barkushe – arterie
- C) veshore – barkushe
- D) arterie – barkushe

Pyetja 315

Një nga funksionet e mëposhtme NUK i përket gjakut:

- A) transportues
- B) homeostatik
- C) mbrojtës
- D) tretës

Pyetja 316

Gjitarët kanë sistem të dyfishtë të qarkullimit të gjakut, ndërsa peshqit kanë sistem të njëfishtë. Sistemi i dyfishtë ka përparësi krahasuar me atë të njëfishtë sepse:

- A) gjaku transportohet me trysni të ulët
- B) gjaku transportohet me trysni të lartë
- C) indet furnizohen me dioksid karboni
- D) mushkëritë furnizohen me dioksid karboni

Pyetja 317

Tufa e Hisit e merr fillimin në:

- A) veshore
- B) barkushe
- C) nyjen sinoatriale
- D) nyjen atrioventrikulare

Pyetja 318

Eritrocitet tek njeriu:

- A) nuk kanë bërthamë
- B) kryejnë fagocitozë
- C) kanë formë të çrregullt
- D) prodhojnë antitropa

Pyetja 319

Qelizat e bardha të gjakut(leukocitet):

- A) përmbajnë hemoglobinë
- B) transportojnë oksigjen
- C) kanë formë disku
- D) kanë bërthamë



Pyetja 320

Kur lëngu indor hyn në kapilarët limfatikë quhet limfë. Rrjedhja e limfës në enët limfatike mundësohet nga:

- A) lëshimi i muskujve
- B) tkurrja e muskujve
- C) tkurrja e veshores(atrimumit)
- D) tkurrja e barkushes(ventrikulit)

Pyetja 321

Kalimi i glukozës nga epiteli i zorrës së hollë, në gjak bëhet me:

- A) pompa
- B) kotransport
- C) difuzion të thjeshtë
- D) me difuzion të lehtësuar

Pyetja 322

Një pompë membranore është e përbërë nga:

- A) disakaride
- B) fosfolipide
- C) kolesterol
- D) proteina

Pyetja 323

Cila nga molekulat e mëposhtme kalon më lehtë përmes membranës?

- A) Alkooli
- B) Glukoproteina
- C) Kolesteroli
- D) Proteina

Pyetja 324

Termi kotransport përdoret për të përshkruar?

- A) Kalimin e 2 lëndëve nëpërmjet 2 transportuesëve ku njëri e përfshin, tjetri e nxjerr jashtë
- B) Transportuesi ka dy site, për të lidhur dhe transportuar 1 molekulë dhe 1 jon
- C) Kalimin e 2 lëndëve nëpërmjet 2 transportuesëve të ndryshëm njëkohësisht
- D) Procesi ku proteina krijon kanal për të kaluar 2 jone njëkohësisht

Pyetja 325

Përthithja e glukozës nga lumeni i zorrës në epitel bëhet:

- A) me anë të difuzionit të thjeshtë
- B) me anë të difuzionit të lehtësuar
- C) me anë të me endocitozë
- D) me anë të kotransportit

Pyetja 326

Uji lëviz nga ksilema në gypat me shoshë sepse:

- A) potenciali i ujit në gypat me shoshë është i lartë
- B) niveli i sakarozës në gypat me shoshë është i ulët
- C) në ksilemë potenciali i ujit është i ulët
- D) potenciali i ujit në gypat me shoshë është i ulët

Pyetja 327

Glikokaliksi është i ndërtuar:

- A) nga zinxhirë karbohidratesh të glikolipideve dhe glikoproteinave
- B) vetëm nga zinxhirët karbohidratesh në përbërje të glikoproteinave
- C) vetëm nga zinxhirë karbohidratesh të glikolipideve
- D) nga zinxhirë karbohidratesh të lirë

Pyetja 328

Membrana bazale, e cila ndodhet midis endotelit dhe podociteve në Kapsulën e Bauman-it është e përbërë nga:

- A) lipide dhe kolesterol
- B) kolesterol dhe glikolipide
- C) glikolipide dhe glikoproteina
- D) kolagjen dhe glikoproteina

Pyetja 329

Transporti i sakarozës nga burimi në vendin e depozitimit bëhet:

- A) në sasi minimale
- B) në sasi maksimale
- C) në të gjitha format
- D) në masë

Pyetja 330

Kotransporti i sakarozës nga indi fotosintetik në gypat me shoshë realizohet nga lëvizja e njëkohshme e saj me jonet:

- A)  $\text{Ca}^{2+}$
- B)  $\text{K}^+$
- C)  $\text{H}^+$
- D)  $\text{Na}^+$

Pyetja 331

Trysnia hidrostatike në trakeidet e ksilemës është:

- A) pozitive sepse dendësia e lëngut është e madhe
- B) pozitive sepse dendësia e lëngut është e vogël
- C) negative sepse dendësia e lëngut është e madhe
- D) negative sepse dendësia e lëngut është e vogël

Pyetja 332

Uji lëviz me osmozë nga ksilema në gypat shoshe sepse:

- A) potenciali uhor në ksilemë është më i vogël, se në gypat shoshe
- B) potenciali uhor në ksilemë është më i madh, se në gypat shoshe
- C) potenciali uhor në ksilemë është i njëjtë, me atë të gypave shoshe
- D) potenciali uhor në ksilemë është i pandryshueshëm

Pyetja 333

Iriqët shpesh ushqehen me lëvoren e pemëve të reja, kjo sjell në disa raste edhe tharjen e tyre sepse:

- A) dëmtohen gypat e ksilemës
- B) dëmtohen gypat e floemës
- C) dëmtohen qelizat e epidermis së lëvores
- D) dëmtohen qelizat e kutikulës

Pyetja 334

Sipërfaqja e zorrës së hollë rritet nga struktura të quajtura:

- A) mikrovile
- B) cilie
- C) flagjelë
- D) vile

Pyetja 335

Auksina kontrollon rritjen e qelizave bimore përmes zgjatjes së tyre. Ky hormon lidhet me receptorin membranor dhe përgjigja është rritja e sasisë së:

- A) ujit që vjen me anë të poreve qelizore si rezultat i uljes së pH
- B) protoneve hidrogjen në mjedisin jashtë qelizor
- C) joneve kalium në mjedisin jashtë qelizor
- D) organeleve qelizore

Pyetja 336

Acidi abshisik(ABA) është një hormon bimor që sintetizohet në çdo qelizë e cila ka kloroplaste dhe amiloplaste. Njëri nga proceset më poshtë NUK nxitet nga prania e tij:

- A) nxitja e mbylljes së gozave tek gjethja
- B) reduktimi i shkallës së transpirimit tek bimët
- C) rritja e sasisë së ujit që vjen me anë të poreve qelizore si rezultat i uljes së pH
- D) ruajtja e ujit në brendësi të organeleve qelizore të bimës

Pyetja 337

Ritmi me të cilin punojnë muskujt e frymëmarrjes dhe për rrjedhojë edhe ritmi i frymëkëmbimit kontrollohet nga:

- A) truri
- B) zemra
- C) muskujt
- D) mushkëritë

Pyetja 338

Çlirimin e alveolave nga pluhurat dhe mbeturinat qelizore e bëjnë të mundur:

- A) receptorët
- B) ciliet dhe mukusi
- C) qelizat epiteliale
- D) qelizat fagocitare

Pyetja 339

Nëse në gjak ka shumë dioksid karboni apo acid laktik, kjo shkakton rënie të pH. Kur truri e ndien këtë, ai dërgon impulse nervore në:

- A) diafragmë, alveola dhe bronke
- B) diafragmë dhe muskujt ndërbrinjor
- C) muskujt ndërbrinjorë dhe bronikola
- D) alveolat, bronkiolat dhe trake

Pyetja 340

Pas sforcimeve fizike, ritmi i frymëmarrjes vazhdon të jetë i lartë sepse:

- A) pH është i lartë dhe truri dërgon sinjale në diafragmë dhe bronkiola
- B) pH është i lartë dhe truri dërgon sinjale në bronke dhe muskuj ndërbrinjor
- C) pH është i ulët dhe truri dërgon sinjale në diafragmë dhe muskuj ndërbrinjor
- D) pH është i ulët dhe truri dërgon sinjale në diafragmë dhe bronkiola

Pyetja 341

Gjatë frymëthithjes ajri futet në mushkëri sepse:

- A) trysnia e ajrit atmosferik është më e madhe se trysnia e ajrit në alveola
- B) trysnia e ajrit në hojëza nuk ndryshon por rritet trysnia e ajrit atmosferik
- C) trysnia e ajrit atmosferik është më e vogël se trysnia e ajrit në alveola
- D) trysnia e ajrit atmosferik është e njëjtë me trysninë e ajrit në alveola

Pyetja 342

Alveolat kanë sipërfaqe shumë të madhe e cila ndikon në:

- A) uljen e shpejtësisë të difuzionit
- B) rritjen e shpejtësisë së difuzionit
- C) uljen e shpejtësisë së transportit aktiv
- D) rritjen e shpejtësisë së transportit aktiv

Pyetja 343

Cila nga lëndët e mëposhtme krijon mjedisin e përshtatshëm për shndërrimin e pepsinogjenit në pepsinë?

- A) Acid karbonik
- B) Acid urik
- C) Acid klorhidrik
- D) Acid nitrik

Pyetja 344

Organet e aparatit tretës mbështillen nga një membrane që quhet?

- A) Sfinkteri kardiak
- B) Perikardi
- C) Sfinkter
- D) Peritoneum

Pyetja 345

Tretja e karbohidrateve fillon:

- A) në gojë nga veprimi i amilazës së pështymës
- B) në gojë nga veprimi i amilazës pankreatike
- C) në duoden nga veprimi i amilazës së pështymës
- D) në duoden nga veprimi i lipazës

Pyetja 346

Kariesi dentar shkaktohet nga:

- A) zbërthimi i lipideve tek dhëmbi në acide yndyrore
- B) depozitimi i copave të ushqimit
- C) depozitimi dhe shpërbërja e sheqernave në acide
- D) depozitimi i kripërave të Ca

Pyetja 347

Sfinkteri kardiak realizon komunikimin midis:

- A) stomakut dhe duodenit
- B) faringut dhe ezofagut
- C) ezofagut dhe stomakut
- D) zorrës së hollë dhe duodenit

Pyetja 348

Pjesa më e madhe e lëndëve ushqimore përthithen në:

- A) stomak
- B) duoden
- C) ezofag
- D) ileum

Pyetja 349

Kolera është një sëmundje:

- A) virale
- B) gjenetike
- C) bakteriale
- D) e shkaktuar nga mjedisi

Pyetja 350

Përcaktimi më i saktë për granulocitet është:

- A) makrofagët
- B) trombocitet
- C) neutrofilet dhe bazofilet
- D) neutrofile, euzinofile dhe bazofile

Pyetja 351

Gjatë procesit të transplantimit, sistemi imunitar nuk bëhet shkak për flakjen e organeve vetëm në rastin e:

- A) binjakëve monozigotikë
- B) binjakëve dizigotikë
- C) individëve të të njëjtit lloj
- D) motrat dhe vëllezërit

Pyetja 352

Imunoglobulinat e tipit IgG, sa zona të lidhjes me antigjenin kanë?

- A) 2
- B) 4
- C) 8
- D) 16

Pyetja 353

Fibrinogjeni që realizon koagulimin e gjakut prodhohet nga:

- A) hipofiza
- B) hipotalamusi
- C) mëlçia
- D) pankreasi

Pyetja 354

Diabeti i tipit 1 është sëmundje që shkaktohet nga:

- A) mosnjohja e receptorit nga insulina
- B) dëmtimi i qelizave  $\alpha$  të Ishujve të Langerhansit
- C) dëmtimi i pjesës ekzokrine të pankreasit
- D) dëmtimi i qelizave  $\beta$  të Ishujve të Langerhansit

Pyetja 355

Cila nga këto qeliza të gjakut kanë bërthamën me lobe?

- A) Eritrocitet
- B) Limfocitet
- C) Monocitet
- D) Neutrofilet

Pyetja 356

Truri kontrollon temperaturën e trupit duke përdorur disa organe si:

- A) lëkurën
- B) stomakun
- C) mushkërinë
- D) veshkat

Pyetja 357

Pjesa më e madhe e ripërthithjes në veshka ndodh në gypin proksimal. Këto qeliza janë përshtatur për të kryer ripërthithjen sepse:

- A) përmbajnë mikrovile që rrisin sipërfaqen
- B) kanë sasi të vogël të mitokondrive
- C) kanë sasi të vogël të proteinave transportuese
- D) janë larg me kapilarët e gjakut

Pyetja 358

Nga vjen gjaku në kapilarët, në kapilarët që rrethojnë gjithë gjatësinë e gypit të nefronit?

- A) Arteriola aferente
- B) Arteriola eferente
- C) Arteria hepatike
- D) Arteria pulmonare

Pyetja 359

Glomerulat e veshkës furnizohen me gjak nga:

- A) arteriola aferente
- B) arteriola eferente
- C) arteria hepatike
- D) vena hepatike

Pyetja 360

Qelizat që formojnë shtresën e brendshme të kapsulës së Bauman-it njihen me emrin?

- A) Qelizat e Malpigit
- B) Qelizat Endoteliale
- C) Qelizat Enterocite
- D) Qelizat Podocite

Pyetja 361

Kontrolli i përqëndrimit të glukozës së gjakut përfshin mekanizmin e feedback-ut negativ. Cilët janë organet efektorë në këtë mekanizëm kontrolli?

- A) Hipotalamusi
- B) Mëlçia
- C) Mushkëria
- D) Pankreasi

Pyetja 362

Kur glukagoni vepron në qelizat e mëlçisë nxit:

- A) aktivizimin e sintezës së glikogjenit nga glukozë
- B) aktivizimin e sintezës së lipideve
- C) aktivizimin e sintezës së proteinave
- D) aktivizimin e enzimave që shndërrojnë glikogjenin në glukozë

Pyetja 363

Roli i acetilkolinesterazës është të nxisë:

- A) hidrolizën e acetilkolinës
- B) sintezën e acetilkolinës
- C) futjen e joneve Ca në neuron
- D) daljen e joneve Ca nga neuroni

Pyetja 364

Neuronet lëvizore transmetojnë impulset nervore:

- A) direkt në efektor
- B) direkt në neuronet ndijore
- C) nga neuronet e ndërmjetme në efektor
- D) nga efektori në neuronet e ndërmjetme

Pyetja 365

Në sinapsin bllokues neuronet parasinaptikë çlirojnë një lloj neurotransmetues që shkakton:

- A) hapjen e kanaleve për  $\text{Na}^+$  dhe futjen e tyre në neuronin passinaptik
- B) hapjen e kanaleve për  $\text{K}^+$  dhe futjen e tyre në neuronin passinaptik
- C) hapjen e kanaleve për  $\text{Ca}^{2+}$  dhe futjen e tyre në neuronin passinaptik
- D) futjen e Cl në neuronin passinaptik

Pyetja 366

Pompa  $\text{Na}^+ - \text{K}^+$  sponstion:

- A) 1 jon  $\text{Na}^+$  dhe 1 jon  $\text{K}^+$  në njëjtin drejtim
- B) 1 jon  $\text{Na}^+$  jashtë dhe 1 jon  $\text{K}^+$  brenda
- C) 3 jone  $\text{Na}^+$  brenda dhe 2 jone  $\text{K}^+$  jashtë
- D) 3 jone  $\text{Na}^+$  jashtë dhe 2 jone  $\text{K}^+$  brenda

Pyetja 367

Trupat e neuroneve lëvizorë, në palcën kurrizore ndodhen:

- A) jashtë SNQ-së
- B) në lëndën e bardhë
- C) në brirët e sipër të lëndës gri
- D) në brirët e poshtëm të lëndës gri

Pyetja 368

Në sinapset kolinergjike, si neurotejtues janë:

- A) acetilkolina
- B) adrenalina
- C) dopamina
- D) noradrenalina

Pyetja 369

Potenciali i qetësisë e ka vlerën afërsisht:

- A) -90 milivolt
- B) -70 milivolt
- C) +30 milivolt
- D) +50 milivolt

Pyetja 370

Veshka kryen të gjitha funksionet e mëposhtme, PËRVEÇ:

- A) eliminimit të proteinave me masë të madhe në gjak
- B) ndërhyr në ruajtjen e ekuilibrit hidro-mineral të organizmit
- C) ndërhyr në rregullimin hormonal të presionit të gjakut
- D) ndërhyr në rregullimin e sasisë së rruazave të kuqe të pranishme në gjak

Pyetja 371

Një nga proceset që ndodhin në tubin e përdredhur distal në veshkë është:

- A) sekretimi pasiv i joneve të hidrogjenit drejtë lëngut indor
- B) transportimi aktiv i  $K^+$  nga lëngu indor në hapësirat e gypit
- C) transporti aktiv i  $Na^+$  nga lëngu indor në gyp
- D) ripërthithje e kufizuar e ujit

Pyetja 372

Gjatë një frike apo stresi, lëkura e njeriut zbehet për shkak të efektit të cilit hormon?

- A) Adrenalinës
- B) Glukagonit
- C) Kortizolit
- D) Insulinës

Pyetja 373

Diametri i arteries aferente renale është:

- A) nuk ka arterie eferente
- B) njësoj si ai i arteries eferente
- C) më i vogël se ai i arteries eferente
- D) më i madh se ai i arteries eferente



Pyetja 374

Membrana bazale që ndodhet midis endotelit të glomerulës dhe podociteve të nefronit ndalon kalimin nga plazma në Kapsulën e Bauman-it të:

- A) molekulave të mëdha proteinike
- B) aminoacideve
- C) glukozës
- D) uresë

Pyetja 375

Uretra e femrave është:

- A) në të njëjtën gjatësi me uretrën e meshkujve
- B) ndryshon përmasat në varësi të moshës
- C) më e shkurtër se uretra e meshkujve
- D) më e gjatë se uretra e meshkujve

Pyetja 376

Cili nga pohimet NUK ka lidhje me transportin e uresë në segmente të ndryshme të nefronit:

- A) burimi kryesor i uresë tubulare është plazma nëpërmjet ultrafiltratit glomerular
- B) përqendrimi i uresë në lumenin e kanaleve grumbulluese kortikale rritet ndërsa uji ripërthithet
- C) laku i hollë Henle dhe kanali grumbullues medular janë të depërtueshëm ndaj uresë
- D) përqendrimi i uresë në lumenin e kanaleve grumbulluese kortikale ulet ndërsa uji ripërthithet

Pyetja 377

Qelizat e gypit mbledhës në veshka shërbejnë si shenjë për cilin nga hormonet e mëposhtme:

- A) oksitocina
- B) eritropoetina
- C) ADH-së
- D) adrenalinës

Pyetja 378

Gjatë kalimit të urinës në gypin mbledhës, uji mund të largohet në saj të:

- A) transportit pasiv
- B) transportit aktiv
- C) kottransportit
- D) osmozës

Pyetja 379

Në gypin e përdredhur distal,  $\text{Na}^+$ :

- A) pompohet aktivisht nga gypi në lëngun indor
- B) pompohet aktivisht nga lëngu indor në gyp
- C) transportohet me difuzion të lehtësuar nga gypi në lëngun indor
- D) transportohet me proteina kanalore nga lëngu indor në gyp

Pyetja 380

Cilin nga efektet e mëposhtme ka ADH në tubin e përdredhur distal?

- A) Uljen e ripërthithjes së ujit
- B) Rritjen e ripërthithjes së ujit
- C) Uljen e përqendrimit të urinës
- D) Rritjen e volumit të urinës

Pyetja 381

Grami është bimë barishtore që riprodhohet në mënyrë aseksuale me rizomë.

Një studiues shqyrtoi 5 bimë grami dhe matì gjatësitë e rizomave A dhe B.

Rezultatet tregohen në tabelë.

Bima	Rizoma A në mm	Rizoma B në mm
1	175	310
2	230	260
3	145	330
4	120	245
5	105	220

Gjatësitë mesatare të rizomës A dhe B janë:

Rizoma A / Rizoma B

- A) 120mm 245mm
- B) 145mm 330mm
- C) 155mm 273mm
- D) 165mm 287mm

Pyetja 382

Molla (*Malus domestica*) është një bimë frutore që i përket familjes Rosaceae. Kur kokrrizat e pjalmnit të një bime me gjenotip (dd) bien mbi krezën e pistilit të një bime me gjenotip (DD), çfarë gjenotipi do të kenë qelizat e embrionit dhe të endospermës së farës?

Embrioni / Endosperma

- A) Dd DDd
- B) Dd Ddd
- C) dd Ddd
- D) dd ddd

Pyetja 383

Supozoni se një grua normale nuk ka lindur kurrë një fëmijë. Bazuar në këto dy të dhëna:

-vezët prodhohen në harkun kohor, 1 vezë çdo 28 ditë (1 cikël menstrual)


-periudha totale riprodhuese e gruas, në mesatare është nga 13-45 vjet

Llogarisni, sa vezë të pjekura do të kishte prodhuar gjatë jetës së saj?

- A) 384
- B) 348
- C) 308
- D) 248

Pyetja 384


Figura e mëposhtme paraqet aparatet e riprodhimit të mashkulli. Cila është rruga e saktë e ejakulimit të spermatozoideve nga trupi?



- A) A → C → G
- B) A → C → B
- C) E → F → H
- D) D → F → G

Pyetja 385


Cila strukturë siguron temperaturën optimale për prodhimin e spermatozoideve?



- A) Struktura A
- B) Struktura D
- C) Struktura F
- D) Struktura G

Pyetja 386

Në figurën e mëposhtme janë treguar proceset që ndodhin në riprodhimin e njeriut. Cila nga alternativat e mëposhtme tregon saktë proceset e përfaqësuara nga numrat në figurë?



- A) 1-Mitozë, 2-Mejozë, 3-Fekondim, 4-Zhvillim
- B) 1-Mejozë, 2-Mejozë, 3-Fekondim, 4-Zhvillim
- C) 1-Mejozë, 2-Mitozë, 3-Diferencim, 4-Fekondim
- D) 1-Mitozë, 2-Mitozë, 3-Diferencim, 4-Fekondim

Pyetja 387

Tek një person, i cili jeton për një kohë të gjatë në lartësi të mëdha, mbi nivelin e detit shkaktohet:

- A) rritje të prodhimit të eritrociteve
- B) ulje të prodhimit të eritrociteve
- C) rritje të prodhimit të leukociteve
- D) ulje të prodhimit të leukociteve

Pyetja 388

Enzima e cila shndërron fibrinogjenin në fibrinë gjatë mpiksjes së gjakut është:

- A) anhidraza
- B) trombina
- C) amilaza
- D) katalazë

Pyetja 389

Ena e gjakut, në të cilën arrijnë molekulat e oksigjenit pasi janë përthithur nga alveolat është?

- A) Arteriolat
- B) Trungu i aortës
- C) Vena mushkërore
- D) Arteria mushkërore

Pyetja 390

Personi i moshës 50 vjeç, i është nënshtruar një kontrolli mjekësor. Mjeku e këshilloi për të bërë një ndërhyrje të quajtur bypass. Cila prej enëve të gjakut është bllokuar tek ky pacient?

- A) Vena zgavrore e sipërme
- B) Arteriet koronare
- C) Kapilari arterial
- D) Venat karotide

Pyetja 391

Hemoglobina është molekulë proteinike me strukturë kuaternare, e cila transporton oksigjenin. Struktura sekondare e kësaj proteine ka të bëjë me:

- A) renditjen lineare të aminoacideve në secilin zinxhir polipeptidik
- B) palosjen e çdo zinxhiri në strukturë globulare
- C) organizimin e veçantë të zinxhirëve polipeptidikë
- D) organizimin e çdo zinxhiri në strukturë  $\alpha$  helikale

Pyetja 392

Debiti kardiak është vëllimi i gjakut të pompuar nga:

- A) një ventrikuli zemrës gjatë një minute
- B) një atrium i zemrës gjatë një minute
- C) dhomat e zemrës gjatë një minute
- D) ventrikuli dhe atrium i zemrës gjatë një minute

Pyetja 393

Limfocitet  $\beta$  ndihmojnë në mbrojtjen e trupit nga sëmundjet sepse ato prodhojnë:

- A) antigjene
- B) antibiotikë
- C) antitropa
- D) antitoksina

Pyetja 394

Kur përqendrimi i insulinës është i ulët, proteina transportuese të glukozës gjenden:

- A) në fshikat në bërthamë
- B) në fshikat në citoplazëm
- C) ndodh fuzimi i fshikave me membranën plazmatike
- D) proteinat transmembranore të glukozës nuk janë sintetizuar

Pyetja 395

Kur adrenalina vepron në receptorin transmembranor, të qelizave të mëlçisë, mesazheri sekondar që formohet brenda qelizës është?

- A)  $Ca^{2+}$
- B) Digliceroli
- C) AMP ciklike
- D) GMP ciklike

Pyetja 396

Tek njeriu testikujt prodhojnë hormonin testosteron. Çfarë do të ndodhë tek një mashkull në rast se adenohipofiza nuk prodhon LH?

- A) Testikujt nuk do të ndryshojnë sasinë e testosteronit
- B) Testikujt nuk do të prodhojnë fare testosteron
- C) Testikujt do të prodhojnë më pak testosteron
- D) Testikujt do të prodhojnë më shumë testosteron

Pyetja 397

Tek femrat adenohipofiza prodhon hormonet FSH dhe LH. Çfarë do të ndodhë me këto hormone, në rast se sasia e hormonit progesteron mbahet e lartë?

- A) FSH dhe LH nuk ndikohen nga progesteroni
- B) FSH dhe LH nuk do pësojnë ndryshime
- C) FSH dhe LH do të zvogëlohen
- D) FSH dhe LH do të rriten

Pyetja 398

Kur përqendrimi i glukozës në gjak kalon pikun optimal, prodhimi i glukagonit:

- A) ulet
- B) rritet
- C) nuk ndryshon
- D) ulet prodhimi insulinës

Pyetja 399

Një pacient ka të dëmtuar qelizat beta, të ishujve të Langerhansit në pankreas. Si do të ndikojë kjo ngjarje në nivelin e sheqerit në gjak?

- A) Glicemia do të ulet
- B) Glicemia do të mbahet në normë
- C) Glicemia nuk varet nga qelizat beta
- D) Glicemia do të rritet

Pyetja 400

Në cilat nga pohimet e mëposhtme jepet më i plotë funksioni i testosteronit?

- A) Të formojë rrugët gjenitale ♂
- B) Të formojë rrugët gjenitale ♂ + spermatogjenezë
- C) Të formojë rrugët gjenitale ♂ + spermatogjenezë + muskulaturë skeleti
- D) Të formojë rrugët gjenitale ♂ + spermatogjenezë + tipare dytësore